

## **Për të filluar ..... 5**

Ndezja e telefonit, telefonatat, lundrimi, gjuha në telefon, mënyra e të shkruarit, tastet, menutë.

## **Telefonimi ..... 21**

Telefonatat, videotelefonatat, kontaktet, lista e telefonatave, telefonimi i shpejtë, kontrolli zanor, grupet, kartëvizitat.

## **Mesazhimi ..... 39**

Mesazhimi shkrimor, mesazhimi-figurë, mesazhimi zanor, posta elektronike (PE), Shokët e mi.

## **Trajtimi i imazhit ..... 53**

Kamera, video, blogu, fotot, PhotoDJ™, temat.

## **Për dëfrim ..... 59**

Riprodhuesi muzikor, riprodhuesi video, radioja, PlayNow™, regjistruesi zanor, lojërat.

## **Lidhshmëria ..... 70**

Cilësimet, Interneti, RSS, sinkronizimi, teknologjia Bluetooth™, kabllit USB, shërbimi përditësues.

## **Tipare të tjera ..... 82**

Ora me zile, kalendari, detyrat, profilet, ora dhe data, kyçi i kartës SIM etj.

## **Mënjanimi i problemeve .. 90**

Pse nuk punon telefoni ashtu siç e dua unë të punojë?

## **Të dhëna të rëndësishme ..... 96**

Selia në Web e Sony Ericsson për konsumatorin, shërbim dhe asistencë teknike, përdorim i sigurt dhe i frytshëm, marrëveshja e licensës së përdoruesit, garancia, declaration of conformity.

## **Treguesi alfabetik ..... 107**

## Sony Ericsson K530i

UMTS 2100

GSM/GPRS 900/1800/1900

Ky Udhëzues përdorimi botohet nga Sony Ericsson Mobile Communications AB ose nga filialja e saj lokale, pa ndonjë garanci. Sony Ericsson Mobile Communications AB ose filialja e saj lokale mund t'i bëjnë përmirësime ose ndryshime këtij Udhëzuesi përdorimi për shkak gabimesh shtypji, pasaktësisht në të dhënat, ose përmirësimesh në programet dhe/ose në pajisjet, në çdo kohë dhe pa paralajmërim. Ndryshime të tilla, në çdo rast, do të pasqyrohen në botimet e reja të këtij udhëzuesi. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

©Sony Ericsson Mobile Communications AB, 2008

Botim numër: SQ/LZT 108 9411 R1B

Vini re:

Disa nga shërbimet e përshkruara në këtë udhëzues përdorimi nuk përballohen nga të gjitha rrjetet. *Kjo vlen edhe për numrin ndërkombëtar GSM të urgjencës 112.*

Lidhuni me operatorin e rrjetit ose ofruesin e shërbimit po të mos jeni të sigurt nëse mund ta përdorni apo jo një shërbim të caktuar.

Lexoni kapitujt *Udhëzime për përdorim të sigurt dhe të frytshëm* dhe *Garancia e kufizuar* para se të filloni ta përdorni telefonin.

Telefoni juaj është në gjendje të shkarkojë, ruajë dhe përcjellë palëve të treta materiale të tjera, p.sh. tone zileshe. Përdorimi i materialeve të tilla mund të kufizohet ose ndalohet për shkak të së drejtave të palëve të treta, duke përfshirë kufizimet parashikuar në ligjet e aplikueshme për mbrojtjen e të drejtave të autorit, por pa u kufizuar me to. Ju, jo Sony Ericsson, mbani përgjegjësi të plotë për materiale shtesë që shkarkoni në telefonin tuaj celular, ose u përcillni të tjerëve nga telefoni juaj. Para se të përdorni një material shtesë çfarëdo, sigurohuni se përdorimi që keni në mend është i licensuar ose pëmdryshe i autorizuar. Sony Ericsson nuk garanton saktësinë, integritetin ose cilësinë e materialeve shtesë ose çdo lloj materiali tjetër me prejardhje nga palë të treta. Në asnjë rrethanë nuk mund t'i lihet Sony Ericsson përgjegjësia për përdorim të papërshtatshëm, nga ana juaj, të materialeve shtesë ose materialeve të tjera me prejardhje nga palë të treta.

Logoja Liquid Identity, PlayNow, MusicDJ, PhotoDJ, VideoDJ dhe TrackID janë marka tregtare ose marka të regjistruara të Sony Ericsson Mobile Communications AB.

Sony, Memory Stick Micro, dhe M2 janë marka tregtare të Sony Corporation. Ericsson është markë tregtare, ose markë e regjistruar e Telefonaktiebolaget LM Ericsson.

Bluetooth™ është markë tregtare ose markë e regjistruar e Bluetooth SIG Inc.

TrackID™ funksionon e fuqizuar nga Gracenote Mobile MusicID™. Gracenote dhe Gracenote Mobile MusicID janë marka tregtare të Gracenote, Inc.

Real është markë tregtare ose markë e regjistruar e RealNetworks, Inc. RealPlayer® for Mobile përfshihet me licensë të RealNetworks, Inc. Copyright 1995-2007, RealNetworks, Inc. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Adobe™ Photoshop™ Album Starter Edition është markë tregtare ose markë e regjistruar e Adobe Systems Incorporated.

Microsoft, Windows dhe PowerPoint janë ose marka të regjistruara ose marka tregtare të Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose në vende të tjera.

T9™ Text Input është markë tregtare ose markë e regjistruar e Tegic Communications. T9™ Text Input është e licensuar nga një nga patentat e mëposhtme: Patentat amerikane no. 5,818,437, 5,953,541, 5,187,480, 5,945,928, dhe 6,011,554; patenta kanadeze no. 1,331,057; patenta britanike no. 2238414B; patenta standard e Hong Kong-ut no. HK0940329; patenta e Republikës së Singaporit no. 51383; patenta evropiane No. 0 842 463 (96927260.8) DE/DK, FI, FR, IT, NL, PT, ES, SE, GB; dhe patenta të tjera në miratim e sipër në mbarë botën.

Java dhe të gjitha markat tregtare dhe logot e bazuara në Java janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të Sun Microsystems, Inc. në SHBA dhe në vende të tjera.

Marrëveshja e licensës së përdoruesit për Sun™ Java™ J2ME™.

- 1 Kufizimet: Programet janë informacion fshehtësësor dhe i mbrojtur me të drejta të autorit i Sun, që i ruan këto të drejta ndaj të gjitha kopjeve, vetë ose nëpërmjet licensuesve të vet. Klienti nuk duhet t'i modifikojë, dekompijojë, zbërthejë, deshifrojë, ekstrakttojë ose kundër-inxhinierojë në ndonjë mënyrë tjetër Programet. Programet nuk mund të jepen me qera, shpërndahen ose nën-licensohen në tërësi ose pjesërisht.
- 2 Rregulloret e eksportit: Programet, duke përfshirë të dhënat teknike, u nënshtrohen ligjeve amerikane të kontrollit të eksportit, duke përfshirë Aktin Amerikan të Administrimit të Eksportit (U.S. Export Administration Act) dhe rregulloret që i bashkëlidhen, dhe mund t'u nënshtrohen rregulloreve të eksportit ose të importit në vende të tjera. Klienti zotohet se do t'u përmbahet me rreptësi rregulloreve të tilla dhe pranon se është përgjegjësia e tij të sigurojë licensa për të eksportuar, riekportuar, ose importuar Programet. Programet nuk mund të shkarkohen, ose të eksportohen a të riekportohen (i) në Kubë, Irak, Iran, Kore të Veriut, Libi, Sudan, Siri ose prej ndonjë qytetari ose personi me banim në këto vende (kjo listë mund të ndryshohet herë pas here), ose në ndonjë vend tjetër ndaj të cilit SHBA zbaton një embargo mallrash, ose (ii) prej kujtdo tjetër që figuron në listën e Vendeve me Trajtim të Posaçëm (Specially Designated Nationals) të Departamentit Amerikan të Thesarit ose në Tabelën e Refuzimit të Porosive (Table of Denial Orders) të Departamentit Amerikan të Tregtisë.

- 3 Të drejtat e kufizuara: Përdorimi, shumëfishimi ose divulgimi nga qeveria e Shteteve të Bashkuara u nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në Dispozitat për të Drejtat në të Dhëna Teknike dhe Programe Kompjuterike (Rights in Technical Data and Computer Software Clauses) në DFARS 252.227-7013(c) (1) (ii) dhe FAR 52.227-19(c) (2) sipas rastit.

Emra të tjerë produktesh dhe kompanish që përmenden në këtë dokument mund të jenë marka tregtare të pronarëve përkatës.

Të gjitha ato të drejta nga të cilat nuk është hequr dorë shprehimisht, mbeten të rezervuara.

Të gjitha ilustrimet janë vetëm për shembëllzim dhe mund të mos i përgjigjen saktësisht telefonit real.

## Simbolet udhëzuese

Në këtë udhëzues përdorimi përdoren simbolet e mëposhtme:



Shënim



Shërbimi ose funksioni varen nga rrjeti ose nga pajtimtaria. Lidhuni me operatorin e rrjetit për hollësi të mëtejshme.



Shih edhe faqen ...



Përdorni tastin përzgjedhës ose tastin e lundrimit për t'u zhvendosur dhe për të përzgjedhur ➔ *14 Lundrimi*.



Shtypeni tastin e lundrimit në qendër.



Shtypeni tastin e lundrimit sipër.



Shtypeni tastin e lundrimit poshtë.



Shtypeni tastin e lundrimit majtas.



Shtypeni tastin e lundrimit djathtas.

## Për të filluar

*Ndezja e telefonit, telefonatat, lundrimi, gjuha në telefon, mënyra e të shkruarit, tastet, menutë.*


Të dhëna të tjera dhe materiale të shkarkueshme mund të gjenden në [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

## Montimi


Para se të filloni ta përdorni telefonin, duhet të futni kartën SIM dhe baterinë.


### Karta SIM

Kur regjistrohemi si pajtimtar pranë një operatori të rrjetit, ju jepet një kartë SIM (Modul i Identitetit të Pajtimtarit ose Subscriber Identity Module në anglishte). Karta SIM përmban një mikroprocesor në të cilin janë regjistruar, mes të tjerash, numri juaj i telefonit, shërbimet që përfshihen në pajtimtarinë tuaj dhe emra e numra telefoni të kontakteve tuaja.

 *Para se ta hiqni kartën SIM nga një telefon tjetër, ruajini atje të dhënat për kontaktet, për t'i përdorur me telefonin e ri; meqë mund t'i keni pasë ruajtur në kujtesën e telefonit.*

### PIN

Për të nisur telefonin dhe aktivizuar shërbimet, mund t'ju duhet të paraqitni një numër PIN (Numër të Identitetit Personal, ose Personal Identification Number në anglishte). Kur e futni numrin PIN, çdo shifër do të afishohet si \*, përveçse kur kodi juaj PIN nis me shifrat e numrit të urgjencës, për shembull 112. Kjo bëhet që ju të kryeni telefonata të urgjencës, pa qenë nevoja të futni një PIN. Shtypni  për të ndrequr gabimet.


 *Nëse e futni kodin PIN gabim tri herë radhazi, do të afishohet kumti PIN i bllokuar. Për ta zhbllokuar, duhet të futni kodin PUK (Numrin Personal të Zhbllokimit ose Personal Unblocking Key në anglishte) ➡ 87 Kyçi i kartës SIM.*

### Bateria

Disa funksione përdorin më shumë energji baterie se të tjerat dhe mund kërkojnë që ta ringarkoni telefonin më shpesh. Kur koha e bisedës ose e gatishmërisë vjen duke u shkurtuar ndjeshëm, bateria është mirë të zëvendësohet. Përdorni vetëm bateri të miratuara Sony Ericsson ➡ 99 Bateria.


## Karta SIM dhe bateria

### Për të futur kartën SIM





- 1 Hiqni mbulesën e baterisë.
- 2 Rrëshqiteni kartën SIM në mbajtësen e vet, me kontaktet ngjyrë ari të kthyer nga poshtë.

### Për të futur baterinë



- 1 Futeni baterinë me anën e etiketës nga lart dhe kontaktet elektrike të kthyer nga njëri-tjetri.
- 2 Rivendoseni mbulesën e baterisë dhe rrëshqiteni që të zërë vend mirë.

### Për të ngarkuar baterinë



- 1 Lidhni batingarkuesin me telefonin. Mund të duhen afërsisht 2.5 orë për ta ngarkuar baterinë plotësisht. Shtypni një tast çfarëdo për të parë ekranin.
- 2 Shkëputeni ngarkuesin duke e përkulur spinën së larti.

### Për ta ndezur telefonin

Para se ta ndizni telefonin, sigurohuni që është i ngarkuar dhe ka kartë SIM të instaluar. Pasi ta ndizni telefonin, përdorni udhëzoren e konfigurimit për ta përgatitur për përdorim lehtë dhe pa vonesë.

## Për ta ndezur telefonin



- 1 Shtypni për pak çaste ①. Ndezja për herë të parë mund të zgjatë disa minuta.
- 2 Përzgjidhni një profil:
  - **Normal** – me funksionalitet të plotë.
  - **Avion** – me funksionalitet të kufizuar, duke i mbajtur të fikur transmetuesit e rrjetit dhe Bluetooth™.
- 3 Futni numrin PIN të kartës SIM, po t'ju kërkohet.
- 4 Kur ta ndizni telefonin për herë të parë, përzgjidhni gjuhën që do të përdorin menutë e telefonit.
- 5 ► Po që t'ju ndihmojë udhëzori i konfigurimit.
- 6 Ndiqni udhëzimet për ta plotësuar konfigurimin. Për të dhëna të mëtejshme, ► 8 *Menuja e profilit Avion*



Po të keni cilësime të paravendosura në telefon, mund të mos ju duhen të tjera. Nëse përdorni shërbimin Shkarko cilësime, duhet të pranoni ta regjistroni telefonin në Sony Ericsson. Telefoni do të dërgojë një mesazh shkrimor. Asnjë informacion vetjak nuk do t'i përcillet Sony Ericsson, as do të përpunohet prej tyre.

Lidhuni me operatorin e rrjetit ose ofruesin e shërbimit për të marrë të dhëna të mëtejshme.

## Gatishmëria

Pasi ta keni ndezur telefonin dhe të keni futur kodin PIN, në ekran do të afishohet emri i operatorit të rrjetit. Kjo quhet gatishmëri.

## Ndihma në telefon

Në telefon mund të gjeni ndihmë dhe të dhëna në çdo kohë.

### *Për të përdorur udhëzoriin e konfigurimit*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - **Cilësimet** ► kartela **Të përgjithshme**
  - **Udhëzori konfigur.** dhe përzgjidhni një mundësi shtesë:
    - Shkarko cilësime
    - Konfigurimi bazë
    - Këshilla & teknika.

## ***Për të parë të dhëna për funksionet***

- Shkoni te një funksion ► **Info**, nëse ekziston.

## ***Për të parë një demonstrim të telefonit***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Dëfrim** ► **Vizitë demo**.

## **Shkarkoni cilësimet**

Konfiguroni automatikisht në telefon funksione që përdorin Internetin; Interneti, mesazhimi-figurë, posta elektronike, Shokët e mi, sinkronizimi, shërbimi përditësues, blogu dhe leximi tranzit.

Mund të përdorni shërbimin **Shkarko cilësime** nëse karta juaj SIM e përballon, telefoni juaj është i lidhur me rrjetin, ndezur në profilin normal dhe nuk përmban cilësime të paracaktuara.



*Lidhuni me operatorin e rrjetit ose ofruesin e shërbimit për të marrë të dhëna të mëtejshme.*

## **Menuja e profilit Avion**

Në qoftë se e ndizni telefonin dhe aktivizoni menunë **Avion**, përzgjidhni midis **Normal** me funksionalitet të plotë, ose **Avion** me funksionalitet të kufizuar. Transmetuesit e rrjetit dhe Bluetooth do të fiken, për të shmangur

ndonjë interferencë me pajisjet e avionit. Megjithatë, ju mund të dëgjoni muzikë, ose të shkruani një mesazh shkrimor për ta dërguar më vonë; por jo të telefononi kur jeni në avion.



*Ndizni rregulloret e fluturimit dhe udhëzimet e personelit në avion për përdorimin e pajisjeve elektronike.*

## ***Për të parë mundësitë shtesë të menisë Avion***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Cilësimet** ► **kartela Të përgjithshme** ► **Avion** dhe përzgjidhni një mundësi shtesë.

## **Për të telefonuar**

Telefoni duhet të jetë në profilin normal (jo për avion).

### ***Për të bërë një telefonatë***

- 1 Futni një numër telefoni (me prefiks in ndërkombëtar dhe prefiks in zonal, nëse ka të tillë).
- 2 ► **Telefono për të bërë një telefonatë zanore** ose ► **Të tjera** ► **Bëj telef. video për të bërë një videotelefonatë**.
- 3 ► **Të tjera për mundësi shtesë gjatë telefonatës**.
- 4 ► **Mbaroje për ta përfunduar telefonatën**.





## Menuja e veprimeve

Menunë e veprimeve mund ta hapni praktikisht nga kudo që të ndodhni në telefon, për të parë dhe për të trajtuar ngjarje të reja, si dhe për të përdorur kujtesore dhe shkurtores.

### *Për të hapur dhe mbyllur menunë e veprimeve*

- Shtypni .

### Kartelat e menusë së veprimeve

- Ngjarje reja – të tilla si telefonata dhe mesazhe të humbura. Kur të ndodhë një ngjarje e re, kartela do të afishohet. Shtypni  për ta shpërfillur një ngjarje nga kartela e ngjarjeve. Ngjarjet e reja mund edhe të cilësohen në mënyrë të tillë që të afishohen si pop-up; nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja ► Cilësimet ► kartela ► përgjithshme ► Ngjarje reja ► Pop-up**.
- Aplikac. aktive – aplikacione që janë aktive në sfond. Përzgjidhni një aplikacion për t'u kthyer atje, ose shtypni  për ta mbyllur.
- Shkurtores e mia – shtoni e fshini shkurtores, ose ndërrojuani renditjen. Kur përzgjidhni një shkurtores dhe hapet aplikacioni, programet e tjera do të mbyllën ose minimizohen.

- Internet – kujtesoret tuaja të Internetit. Kur përzgjidhni një kujtesore dhe hapet shfletuesi, programet e tjera do të mbyllën ose minimizohen.

## Programet PC Suite

Për t'i shfrytëzuar më mirë funksionet e telefonit tuaj, mund të instaloni atje programet PC Suite. Kjo do t'ju lejojë, për shembull, të sinkronizoni kalendarin që keni në telefon me një kalendar në kompjuter.


### *Për të instaluar programet PC Suite*












- 1 Ndizeni kompjuterin dhe futni CD-në që ju erdhi me telefonin në lexuesin CD të kompjuterit tuaj. CD do të niset automatikisht, duke hapur një dritare të instalimit.
- 2 **Në kompjuter:** Përzgjidhni një gjuhë dhe klikoni **OK**.
- 3 **Në kompjuter:** Klikoni **Install** (Instalo) në seksionin e PC Suite dhe ndiqni udhëzimet në ekran. Kur të ketë përfunduar instalimi, ikona e PC Suite do të afishohet në tryezë të kompjuterit.



*Për të marrë versionin më të fundit të PC Suite, shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).*

## Vështrim i përgjithshëm mbi telefonin



- 1 Foleja e Memory Stick Micro™ (M2™)
- 2 Ekрани
- 3  Tasti përzgjedhës
- 4  Tasti i Internetit
- 5  Tasti prapa
- 6 Tasti i lundrimit/i funksionit Ripr. muzikor
- 7  Tasti kyçës
- 8  Butoni Ndiz/Fik
- 9 Kamera e videotelefonatës
- 10 Mikrofolësi
- 11  Butonat e volumit/zoom-it numerik të kameras
- 12  Tasti përzgjedhës
- 13  Tasti i menisë së veprimeve
- 14  Tasti C (Fshij)
- 15  Butoni i kameras
- 16  Tasti i heshtimit
- 17 Konektori për ngarkuesin, sistemin pa duar dhe kabllin USB
- 18 Syri i kameras

Për të dhëna të mëtejshme ➡ 14 Lundrimi.

## Pamje e përgjithshme e menuve



PlayNow™\*



Internet\*



Dëfrim

Shërbime në linjë\*  
Lojra  
TrackID™  
Ripr. video  
VideoDJ™  
PhotoDJ™  
MusicDJ™  
Telekomandimi  
Regjistrim zëri  
Vizitë demo



Kamera



Mesazhimi

Krijo të ri  
Kutia në hyrje  
PE  
Lexuesi RSS  
Skica  
Kutia në dalje  
Mszhe dërguar  
Mesazhe ruajtur  
Shokët e mi\*  
Tlfn. pst.zanore  
Modelet  
Cilësimet



Ripr. muzikor



Skedari\*/\*\*

Album kamera  
Muzikë  
Fotot  
Videot  
Temat  
Faqe Interneti  
Lojra  
Aplikacione  
Tjetrin



Kontaktet

Kontakt i ri



Radio



## Telefonatat\*\*



Të gjitha



Të përgjigjura



Të kryera



Të humbura



## Organizuesi

Alarmet  
 Aplikacione  
 Telefonatë video  
 Kalendari  
 Detyrat  
 Shënime  
 Sinkronizimi  
 Kohëmatësi  
 Kronometri  
 Llogaritësja  
 Kujtesa kodeve



## Cilësimet\*\*



Të përgjithshme

Profilët

Ora dhe data

Gjuha

Shërbimi prditsues

Komandimi zanor

Ngjarje të reja

Shkurtoret

Avion

Sigurshmëria

Udhëzori konfigur.

Gjendja telefonit

Ricilëso të gjitha



Tinguj & sinjalizime

Volumi i ziles

Toni i ziles

Heshtim

Zile rritëse

Me dritëje

Sinjalizim mesazhi

Tingulli i tastit



Ekрани

Sfondi

Temat

Ekрани në hapje

Ekran-ruajtësja

Përmasat e orës

Ndriçimi

Ndrysho.em.linjave\*



Telefonatat

Telefonim shpejtë

Devijo telefonatat

Kalo te linja 2\*

Trajto telefonatat

Kohzgj. & Kosto\*

Afsho/fshih num.

Pa duar



Lidhshmëria\*

Bluetooth

USB

Sinkronizimi

Trajtim pajisjesh

Rrjetet celulare

Komun. dhanor

Cilësimet Interneti

Cilsm lexim tranzit

Pajisjet shitesë


\* Disa menu varen nga operatori, rrjeti dhe pajtimtaria.

\*\* Përdorni tastet e lundrimit për t'u zhvendosur nga një kartelë në tjetrën, në nënmenutë.

Për të dhëna të mëtejshme ➡ 14 Lundrimi.

## Lundrimi

Menutë kryesore afishohen si ikona.  
Disa nënmenu përmbajnë kartela.  
Shkoni te një kartelë duke shtypur  
↶ ose ↷.



### Tasti

○	Shkoni në menutë kryesore ose përzgjidhni objekte të përshenjuara.
↶ ↷ ↸ ↹	Zhvendosuni nëpër menu dhe kartela.
—	Përzgjidhni mundësitë shtesë që afishohen mbi këto taste në ekran.
↶	Kthehuni një hap prapa në menu. Mbajeni të shtypur për t'u kthyer në gatishmëri ose për ta mbyllur një funksion.
C	Fshini objekte, si foto, skeda zanore dhe kontakte. Mbajeni të shtypur gjatë një telefonate, për të heshtuar mikrofonin.
☰	Hapni menunë e veprimeve ➤ <b>9 Menuja e veprimeve.</b>
⊕	Hapni shfletuesin.
📷/📹	Shtypeni për të nxjerrë një foto ose për të regjistruar një videoklip.
1	Mbajeni të shtypur kur jeni në gatishmëri, për t'i telefonuar shërbimit të postës zanore (po të jetë cilësuar).
2 - 9	Mbajeni të shtypur cilindo nga këto taste kur jeni në gatishmëri, për të shkuar te një kontakt të cilit i nis emri me një shkronjë specifike.

1 - 9	Shtypni një tast numerik nga gatishmëria, pastaj ► <b>Telefono</b> për telefonim të shpejtë. Shtypeni për të përdorur shkurtove kur po shfletoni ► <b>72 Për të përdorur shkurtoret e tastierës ose tastet e hyrjes në Internet.</b>
0 +	Shihni një udhëzues të shkurtoreve kur përdorni kameran.
* SR →	Shtypeni nga gatishmëria, pastaj ► <b>Kyç.tastet</b> ose <b>Shkyçe</b> për të kyçur ose shkyçur tastet e telefonit.
# →	Fikeni tonin e ziles gjatë një telefonate në hyrje. Mbajeni të shtypur për ta cilësuar telefonin si të heshtuar. Alarmi do të dëgjohet edhe sikur telefoni të jetë i heshtuar.
▲	Shihni të dhëna për gjendjen në gatishmëri. Ngrini volumin gjatë një telefonate, ose kur po përdorni <b>Ripr. muzikor</b> . Bëni zoom zvogëlues kur po përdorni kameran ose po shihni foto. Mbajeni të shtypur për t'u kthyer prapa një titull muzikor. Shtypeni dy herë për ta refuzuar një telefonatë. Mbajeni të shtypur për telefonim zanor, ose thoni fjalën magjike (nëse e keni cilësuar) ► <b>31 Telefonimi zanor.</b>
▼	Ulni volumin gjatë një telefonate, ose kur po përdorni <b>Ripr. muzikor</b> . Bëni zoom zmadhues kur po përdorni kameran ose po shihni foto. Mbajeni të shtypur për shkuar përpara një titull muzikor. Mbajeni të shtypur për telefonim zanor, ose thoni fjalën magjike (nëse e keni cilësuar) ► <b>31 Telefonimi zanor.</b>
► Info	Për të dhëna të mëtejshme, shpjegime ose këshilla për funksione, menu ose tipare të caktuara në telefonin tuaj, ► <b>7 Ndhima në telefon.</b>
► Të tjera	Futuni në një listë mundësish shtesë. Në vartësi të pozicionit që keni në menu, lista e mundësive shtesë do t'ju ofrojë zgjidhje të ndryshme.

## Shiriti i gjendjes

Disa nga ikonat që mund të afishohen:

### Ikona Përshkrimi



Rrjeti 3G (UMTS) mund të përdoret.



Forca e sinjalit të rrjetit GSM.



Gjendja e baterisë.



Po ngarkohet bateria, do të afishohet së bashku me ikonën e gjendjes së baterisë.



Telefonatë e humbur në hyrje.



Më ka mbërritur një mesazh shkrimor.



Më ka mbërritur një mesazh PE.



Më ka mbërritur një mesazh-figurë.



Më ka mbërritur një mesazh i postës zanore.



Telefonatë në vazhdim.



Kyçi i tasteve është aktiv.



Sistemi pa duar është lidhur.



Përkujtesë kalendari.









Përkujtesë detyrash.





## Shkurtoret

Përdorni shkurtoret e tastierës për të shkuar shpejt te një menu; mund edhe të përdorni shkurtoret e paracaktuara të tastit të lundrimit për t'i arritur shpejt disa funksione. Ndryshojini shkurtoret e tastit të lundrimit sipas nevojave tuaja.

### Për të përdorur shkurtoret e tastierës

Nga gatishmëria, shkoni te menutë duke shtypur  pastaj futni numrin e menusë. Numërimi i menuve nis nga ikona lart majtas për t'u zhvendosur anash pastaj poshtë radhë pas radhe, për shembull, shtypni  për menunë e pestë. Për menutë dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë, shtypni ,  dhe  përkatësisht. Për t'u kthyer në gatishmëri, mbani të shtypur .

### Për të përdorur shkurtoret e tastit të lundrimit

Nga gatishmëria, shkoni te një menu ose funksion shkurtoresh duke shtypur , ,  dhe .

### Për të ndryshuar një shkurtores të tastit të lundrimit

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - Cilësimet ► kartela Të përgjithshme
  - Shkurtoret dhe përzgjidhni një shkurtores ► Ndrysho.



## Gjuha në telefon





Përzgjidhni gjuhën që do të përdorni në menutë e telefonit ose kur shkruani.

### *Për t'ia ndërruar gjuhën telefonit*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ **Cilësimet** ▶ **kartela Të përgjithshme**  
▶ **Gjuha** ▶ **Gjuha e telefonit.**

Përzgjidhni një gjuhë.

Nga gatishmëria, mund gjithashtu të shtypni:

-  8888  për përzgjedhje automatike të gjuhës.
-  0000  për anglishte.



*Pjesa më e madhe e kartave SIM e cilësojnë automatikisht si gjuhë të menuve gjuhën e vendit ku e keni blerë kartën. Nëse nuk ndodh kështu, do të përdoret paracaktueshëm anglishtja.*

### *Për të përzgjedhur gjuhën e shkrimit*


- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ **Cilësimet** ▶ **kartela Të përgjithshme**  
▶ **Gjuha** ▶ **Gjuha e shkrimit.**
- 2 Shkoni te gjuha që do të përdorni dhe shenjojeni. ▶ Ruaje për të dalë nga menuja.

## Për të futur shkronja


Kur shkruani, p.sh. mesazhe, shkronjat mund t'i futni në një nga mënyrat shkrimore të mëposhtme:

- Mënyra shumëshypëse e të shkruarit
- Mënyra T9™ Text Input

### *Për ta ndryshuar mënyrën e futjes së tekstit*

- Para se t'i futni shkronjat, ose kur po i futni, mbani të shtypur  për të ndryshuar mënyrën shkrimore.







### *Për ta ndërruar gjuhën e shkrimit*

- Para se t'i futni shkronjat, ose kur po i futni, mbani të shtypur  dhe përzgjidhni një tjetër gjuhë shkrimi.

### *Mundësi shtesë kur po futni shkronja*

▶ Të tjera për mundësi shtesë kur po shkruani një mesazh.

### *Për të futur shkronja me mënyrën shumëshypëse*

- Shtypni  -  disa herë, derisa të afishohet shenja që dëshironi.
- Shtypni  për t'u këmbyer midis shkronjave të mëdha dhe të vogla.
- Shtypni pak çaste  -  për të futur numra.
- Shtypni  për të fshirë shkronja ose numra.

- Shtypni **(1)** për të përfutur shenja pikësimi të rëndomta.
- Shtypni **(#↵)** për të shtuar një hapësirë fjalëndarëse.

### Mënyra e të shkruarit T9™ Text Input

Mënyra e të shkruarit T9 Text Input përdor një fjalor të vetin që të dallojë fjalën e përdorur më shpesh për çdo kombinim tastshypjesh. Në këtë mënyrë do t'ju mjaftojë ta shtypni një tast vetëm një herë, edhe sikur shkronja që dëshironi të përftoni të mos jetë e para në tast.

#### *Për të futur shkronja duke përdorur mënyrën T9 Text Input*

- 1 Për të futur tekst, duhet të jeni në një funksion ku mund të futet tekst, për shembull, nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Mesazhin ► Krijoi të ri ► Mszh shkrimor.
- 2 Për shembull, për të shkruar fjalën «Jane», shtypni **(5)**, **(2)**, **(6)**, **(3)**.
- 3 Nëse fjala e afishuar është ajo që dëshironi, shtypni **(#↵)** për ta pranuar dhe për të shtuar një hapësirë fjalëndarëse. Për ta pranuar fjalën pa shtuar ndonjë hapësirë, shtypni **(↵)**. Nëse fjala e afishuar nuk është ajo që dëshironi, shtypni **(↵)** ose **(↵)** disa herë

për të parë sugjerime të tjera. Pranojeni fjalën dhe shtoni një hapësirë fjalëndarëse duke shtypur **(#↵)**.

- 4 Vazhdoni të shkruani mesazhin. Për të futur një shenjë pikësimi, shtypni **(1)** pastaj **(↵)** ose **(↵)** disa herë, shtypni **(#↵)** për të pranuar dhe për të shtuar një hapësirë fjalëndarëse.

#### *Për të shtuar fjalë në fjalorin e mënyrës T9™ Text Input*

- 1 Kur po futni shkronja ► Të tjera ► Spelloje fjalën.
- 2 Ndryshojeni fjalën me mënyrën shumëshypëse. Përdorni **(↵)** dhe **(↵)** për ta lëvizur kursorin nga një shkronjë tek tjetra. Për të fshirë një shenjë, shtypni **(C)**. Për ta fshirë krejt fjalën, mbani të shtypur **(C)**.  
Pasi ta keni ndryshuar fjalën ► Ndërfute. Fjala do t'i shtohet fjalorit të mënyrës T9™ Text Input. Herën tjetër që do ta futni këtë fjalë me mënyrën shkrimore T9 do të afishohet në një listë fjalësh të sugjeruara.


#### *Parashikimi i fjalës që vijon*

Kur shkruani një mesazh, mund të përdorni mënyrën shkrimore T9 për të parashikuar fjalën që vijon, nëse e keni përdorur më parë në një fjali.

## *Për ta aktivizuar apo çaktivizuar funksionin e parashikimit të fjalës që vijon*

- Kur po futni shkronja ► Të tjera  
► Shtesa shkrimi ► Parashiko.fjl.tjt.

## *Për të përdorur parashikimin e fjalës që vijon*

- Kur po shkruani shkronja, shtypni  për të pranuar ose për të vazhduar.


## **Skedari**

Përdoreni skedarin (Skedari) për të trajtuar objekte të tilla si foto, videoklipe, muzikë, tema, faqe Interneti, lojëra dhe aplikacione të ruajtura në kujtesë të telefonit ose në kartë të kujtesës.

## **Memory Stick Micro™ (M2™)**

Telefoni juaj pranon kartën e kujtesës Memory Stick Micro™ (M2™), çka i shton telefonit hapësirë arkivimi, ku mund të ruani skeda p.sh. zanore ose fotosh.

## *Për ta futur ose hequr kartën e kujtesës*



- 1 Futni kartën e kujtesës si në figurë (me kontaktet të kthyer nga poshtë).
- 2 Shtypeni anën e kartës, për ta liruar dhe hequr nga foleja.

Gjithashtu mund të zhvendosni ose të kopjoni skeda midis një kompjuteri dhe kartës së kujtesës. Kur të jetë e futur karta e kujtesës, skedat do të ruhen automatikisht atje, në qoftë se ju vetë nuk vendosni t'i ruani në kujtesë të telefonit.

Krijoni nënregjistra ku t'i çoni ose t'i kopjoni skedat. Lojërat dhe aplikacionet mund t'i zhvendosni midis regjistrave **Lojra** dhe **Aplikacione** dhe nga kujtesa e telefonit në kartë të kujtesës. Skedat e panjohura do të ruhen në regjistrin **Tjetrin**. Kur trajtoni skeda, mund të përgjithëni njëkohësisht disa syresh ose të gjitha, me përjashtim të skedave në regjistrat **Lojra** dhe **Aplikacione**.

## Gjendja e kujtesës

Nëse nuk ka më vend në kujtesë, do t'ju duhet të fshini ndonjë skedë ekzistuese, para se të ruani skeda të reja. Gjendjen e kujtesës në telefon ose në kartën e kujtesës mund ta kontrolloni duke përshenjuar një regjistër ► Të tjera ► Gjendja kujtesës.

## Kartelat e menuve në skedar

Skedari përmban tri kartela, dhe ikonat përdoren për të treguar se ku janë ruajtur skedat.

- Të gjitha skedat – gjithë ç'përmban kujtesa e telefonit dhe karta e kujtesës.
- Në Memory Stick – gjithë ç'përmban karta e kujtesës.
- Në aparat – gjithë ç'përmban kujtesa e telefonit.

## Të dhëna për skedat

Të dhënat për një skedë mund t'i shihni duke e përshenjuar skedën ► Të tjera ► Informacion. Skedat që keni shkarkuar, ose që ju janë dërguar me ndonjë prej mënyrave të përdorshme të transferimit, mund të mbrohen me të drejta autori. Po të jetë e mbrojtur skeda, ju mund të mos e kopjoni ose dërgoni dot. Skedat e mbrojtura me të drejta autori dallohen nga një simbol çelësi.

## *Për të përdorur një skedë nga skedari*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Skedari dhe hapni një regjistër.
- 2 Shkoni te një skedë ► Të tjera.

## *Për të zhvendosur ose kopjuar një skedë në kujtesë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Skedari dhe përzgjidhni një regjistër.
- 2 Shkoni te një skedë ► Të tjera ► Trajto skedën ► Zhvendose për ta zhvendosur ose ► Të tjera ► Trajto skedën ► Kopjoje për ta kopjuar.
- 3 Vendosni nëse skedën do ta zhvendosni apo kopjoni në Telefon apo Memory Stick.

## *Për të zhvendosur ose kopjuar skeda në një kompjuter*

- ► 79 Për të transferuar skeda me anë të kabllit USB.

## *Për të krijuar një nënregjistër*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Skedari dhe hapni një regjistër.
- 2 ► Të tjera ► Regjistër i ri dhe futni një emër për regjistrin.
- 3 ► OK për ta ruajtur regjistrin.

### *Për të përzgjedhur disa skeda*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Skedari dhe hapni një regjistër.
- 2 ► Të tjera ► Shenjo ► Shenjo disa.
- 3 Lundroni për t'i përzgjedhur skedat ► Shenjo ose Çshenjoje.

### *Për t'i përzgjedhur të gjitha skedat në një regjistër*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Skedari dhe hapni një regjistër ► Të tjera ► Shenjo ► Shnj gjith.

### *Për të fshirë ndonjë skedë ose nënregjistër nga skedari*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Skedari dhe hapni një regjistër.
- 2 Shkoni te një skedë ► Të tjera ► Fshije.

### **Mundësi shtesë për kartën e kujtesës**

Kontrolloni gjendjen e kujtesës, ose formatojeni kartën e kujtesës për t'i fshirë të gjitha ç'ruani atje.

### *Për t'i përdorur mundësitë shtesë për kartën e kujtesës*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Skedari dhe përzgjidhni kartelën Në Memory Stick ► Të tjera për mundësi shtesë.

## Telefonimi

*Telefonatat, videotefonatat, kontaktet, lista e telefonatave, telefonimi i shpejtë, kontrolli zanor, grupet, kartëvizitat.*

### **Për të bërë dhe marrë telefonata**

Para se të mund të bëni ose të merrni telefonata, duhet ta ndizni telefonin dhe të siguroheni se jeni brenda rrezes së një rrjeti. ► **6 Për ta ndezur telefonin.** Për të bërë një videotelefonatë ► **24 Videotelefonata.**

### **Rrjetet**

Kur e ndizni telefonin, rrjeti juaj bazë do të përzgjidhet automatikisht, nëse gjendet brenda rrezes. Në rast se nuk është brenda rrezes, mund të përdorni një rrjet tjetër, me kusht që operatori juaj i rrjetit të ketë një marrëveshje e cila ju lejon të veproni kështu. Kjo quhet roaming.

Përzgjidhni rrjetin që dëshironi të përdorni, ose shtojini një rrjet të ri listës suaj të rrjeteve të preferuara. Mund të ndërroni edhe radhën e përzgjedhjes së rrjeteve gjatë kërkimit automatik.

Telefoni juaj gjithashtu do të këmbëhet automatikisht midis rrjeteve GSM dhe 3G (UMTS), sipas përdorshmërisë. Disa operatorë rrjetesh ju lejojnë t'i këmbëni rrjetet ju vetë, meqë kërkimi automatik për rrjete që nuk janë të përdorshme konsumon energji të baterisë.

### ***Për të parë mundësi shtesë të rrjetit***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - **Cilësimet** ► **kartela Lidhshmëria**
  - **Rrjetet celulare.**

### ***Për të këmbyer rrjet***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - **Cilësimet** ► **kartela Lidhshmëria**
  - **Rrjetet celulare** ► **Rrjetet GSM/3G.**
- 2 ► **GSM dhe 3G (automatik) ose**
  - **Vetëm GSM.**

Për të dhëna të mëtejshme, lidhuni me operatorin e rrjetit.

### ***Për të bërë një telefonatë***

- 1 Futni një numër telefoni (me prefiksën ndërkombëtar të shtetit dhe prefiksën zonal, nëse ka të tillë).
- 2 ► **Telefono për të bërë një telefonatë zanore ose** ► **Të tjera për të parë mundësi shtesë, të tilla si Bëj telef. video** ► **24 Videotefonata.**
- 3 ► **Mbaroje për ta përfunduar telefonatën.**



*Mund t'u telefononi numrave nga lista e kontakteve dhe telefonatave*  
► **25 Kontaktet, dhe** ► **29 Lista e telefonatave.** Mund edhe të përdorni komanda zanore për të telefonuar  
► **30 Komandimi zanor.**

### ***Për të bërë telefonata ndërkombëtare***

- 1 Shtypni pak çaste (**☎**) derisa të afishohet shenja +.
- 2 Futni prefiksën e shtetit, prefiksën e zonës (pa zeron në krye) dhe numrin e telefonit. ► **Telefono për të bërë një telefonatë zanore, ose** ► **Të tjera** ► **Bëj telef. video për të bërë një videotefonatë.**

### ***Për t'i ritelefonuar një numri***

- Nëse lidhja nuk vendoset dot dhe kumti **Të provoj prapë?** afishohet ► **Po.**



*Mos e mbani telefonin në vesh gjatë kohës që prisni. Kur të lidhet telefonata, telefoni ju lajmëron me një sinjal të fortë.*

### ***Për t'iu përgjigjur një telefonate ose për ta refuzuar***

- ► **Përgjigju ose** ► **I zënë.**

### ***Për ta fikur mikrofonin***

- 1 Shtypni për pak çaste (**🔇**).
- 2 Për të vazhduar bisedën, mbani të shtypur (**🔇**) përsëri.

### ***Për të ndezur ose fikur altoparlantin gjatë një telefonate zanore***

- ▶ Të tjera ▶ Ndiz altoparlant. ose Fike altoparlantin.



*Kur përdorni altoparlantin, mos e mbani telefonin te veshi. Kjo mund t'ju dëmtojë dëgjimin.*

### ***Për t'ia ndryshuar volumin mikrofolësit***

- Shtypni për t'ia ngritur, ose për t'ia ulur volumin mikrofolësit gjatë një telefonate.

### **Telefonatat e humbura**

Kur menuja e veprimeve është cilësuar si default, telefonatat e humbura do të afishohen në kartelën Ngjarje të reja në gatishmëri. Po të jetë cilësuar pop-up si default, kumti Telefonata të humbura: do të afishohet në gatishmëri ➤ 9 Menuja e veprimeve.

### ***Për të kontrolluar telefonatat e humbura nga gatishmëria***

- Po të jetë cilësuar menuja e veprimeve si default, shtypni ▶ kartela Ngjarje të reja. Lundroni ose për të përzgjedhur një numër dhe ▶ Telefono për të telefonuar.

- Po të jetë cilësuar afishimi pop-up si default, ▶ Tlfonata ▶ kartela Të humbura. Lundroni ose për të përzgjedhur një numër dhe ▶ Telefono për të telefonuar.

## **Telefonata të urgjencës**

Telefoni juaj përballon numrat ndërkombëtarë të urgjencës, si 112 dhe 911. Këta numra mund të përdoren normalisht për të bërë telefonata të urgjencës në çdo vend që të ndodheni, me ose pa kartë SIM të instaluar, po të gjendeni brenda rrezes së një rrjeti 3G (UMTS) ose GSM.



*Disa vende mund të përdorin numra të tjerë urgjence. Për këtë arsye, operatori juaj i rrjetit mund të ketë regjistruar numra të tjerë vendorë të urgjencës në kartën SIM.*

### ***Për të bërë një telefonatë urgjence***

- Futni, për shembull, 112 (numri ndërkombëtar i urgjencës) ▶ Telefono.

### ***Për të parë numrat tuaj vendorë të urgjencës***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ▶ Kontaktet ▶ Të tjera ▶ Shtesa ▶ Numra specialë ▶ Numra urgjencë.

## Videotelefonata

Shiheni dikë në ekran gjatë telefonatës.



### Para se të filloni

Për të bërë një videotelefonatë, edhe ju edhe pala tjetër duhet të keni një pajtimtari të tillë që ta përballojë shërbimin 3G (UMTS), si dhe të jeni brenda rrezes së një rrjeti 3G (UMTS). Shërbimi 3G (UMTS) është i përdorshëm sa herë ikona 3G afishohet në shiritin e statusit.

### Profili videotelefonik demonstrativ



Shumë prej funksioneve të videotelefonimit mund t'i përdorni pa qenë nevoja të videotelefononi; për shembull, për ta përgatitur pamjen e kameras para se të telefononi, përzgjidhni nga gatishmëria **Menuja** ► **Organizuesi** ► **Tlf. video**.

### Për të bërë një videotelefonatë

- Po të ketë shërbim 3G (UMTS) të përdorshëm, mund të videotelefononi sipas një prej mënyrave në vijim:
  - Futni një numër telefoni (me prefiksën ndërkombëtar dhe prefiksën zonal, nëse ka të tillë) ► **Të tjera** ► **Bëj telef. video**.
  - Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** dhe përzgjidhni kontaktin për t'i telefonuar. Përdorni  ose  për të përzgjedhur një numër ► **Të tjera** ► **Bëj telef. video**.

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - **Organizuesi** ► **Tlf. video**
  - **Tlfono...** ► **Kontaktet** për të përnxjerrë një numër telefoni
  - **Telefono** ose futni një numër telefoni ► **Telefono**.

### *Për të përdorur zoom zmadhues ose zvogëlues me videon në dalje*

- Shtypni  për zoom zmadhues me videon në dalje; shtypni  për zoom zvogëlues.

### *Për të pranuar një videotelefonatë në hyrje*

- **Përgjigju**.

### *Për të përfunduar një videotelefonatë*

- **Mbaroje**.

### Mundësi shtesë të videotelefonatës

- **Të tjera** për mundësitë shtesë të mëposhtme:
- Këmbe kamera** – për t'u këmbyer midis kameras kryesore dhe kameras së videotelefonatës. Përdoreni kameran kryesore për t'i treguar palës tjetër një imazh të plotë të mjedisit ku gjendeni.
- Ndale kameran/Ndiz kameran** – fiken i ose ndizeni videokameran. Kur kamera të jetë fikur, do të afishohet një foto jetër.



- Ruaje foton – ruajeni figurën e afishuar në pamjen e madhe, për shembull, figurën e telefonuesit në hyrje.
- Kamera – mundësitë shtesë
  - Ndryçimi – rregullojeni për figurën në dalje.
  - Ndiz fnks. Natën – përdoreni në kushte ndryçimi të pamjaftueshëm. Ky cilësim do të ndikojë videon në dalje.
- Zëri – për ta cilësuar gjatë videotelefonatës
  - Fike altoparlantin/Ndiz altoparlantin – tingulli në hyrje.
  - Heshto mikrof./Çeshto telefonin – mikrofoni fikur ose nderur.
  - Transfero zërin – për ta transferuar zërin nga një pajisje Bluetooth pa duar, ose drejt një të tille.
- Paraqitja – mundësitë shtesë
  - Këmbe fotot – për ta treguar videon në hyrje ose në dalje në madhësi të plotë.
  - Fshihe minifoton/Afish. foton vogl.
  - Imazh pasqyrë – afishoni figurën e kameras në dalje.
- Cilësimet – kur përgjigjeni
  - Mnyra përgjigjes – cilësojeni kameran e videotelefonimit si aktive ose joaktive.
  - Foto rezervë – cilësoni një figurë që do t'i tregohet marrësit kur kamera të jetë e fikur.
- Shtesa audio – vendosni nëse mikrofoni, altoparlanti, ose të dy bashkë do të jenë aktivë ose joaktivë.
- Cilësia e videos – përzgjidhni cilësinë e figurës për videotelefonatet. Ndryshimet do të kryhen vetëm pasi ta keni përfunduar telefonatën në vazhdim.

## Kontaktet

Të dhënat për kontaktet mund t'i ruani në kujtesën e telefonit ose në një kartë SIM.

Vendosni se çfarë të dhënash për kontaktet – **Kontaktet telef.** apo **Kontaktet SIM** – do të afishohet si default.

### *Për të parë të dhëna dhe cilësime*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - ▶ **Kontaktet** ▶ **Të tjera** ▶ **Shtesa**.





### Kontakti default

Po të keni cilësuar **Kontaktet telef.** si default, në kontaktet tuaja do të tregohen të gjitha të dhënat e ruajtura në **Kontaktet**. Po të cilësoni **Kontaktet SIM** si default, në kontaktet do të afishohen të dhëna që varen nga karta SIM.

### ***Për të përzgjedhur kontaktet default***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Të avancuara ► Kontakte default.
- 2 ► Kontaktet telef. ose Kontaktet SIM.


### **Kontaktet në telefon**

Kontaktet mund t'i ruani në telefon, me emra, numra telefoni dhe të dhëna vetjake. Kontakteve mund t'u shtoni edhe foto ose tone zillesh. Përdorni , ,  dhe  për t'u zhvendosur nëpër kartela dhe në fushat e tyre të të dhënave.

### ***Për të shtuar një kontakt telefoni***

- 1 Po të keni zgjedhur Kontaktet telef. si default, përzgjidhni nga gatishmëria Menuja ► Kontaktet ► Kontakt i ri ► Shto.
- 2 Futni emrin ► OK.
- 3 Futni numrin ► OK.
- 4 Përzgjidhni një mundësi shtesë për numrin.
- 5 Zhvendosuni nëpër kartela dhe përzgjidhni fushat për të shtuar të dhëna. Për të futur simbole të tilla si @, ► Të tjera ► Shto simbol dhe përzgjidhni një simbol ► Ndërfute.
- 6 Kur t'i keni shtuar të gjitha të dhënat ► Ruaje.

### ***Për ta fshirë një kontakt***

- 1 ► Kontaktet dhe shkoni te një kontakt.
- 2 Shtypni  dhe përzgjidhni Po.

### ***Për t'i fshirë të gjitha kontaktet në telefon***

- Në qoftë se Kontaktet telef. është përzgjedhur si default, përzgjidhni nga gatishmëria Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Të avancuara ► Fshij gjith kontaktet ► Po dhe ► Po. Emrat dhe numrat në SIM nuk do të fshihen.

### **Kontaktet në SIM**

Kontaktet mund t'i ruani në kartën SIM.

### ***Për të shtuar një kontakt në SIM***

- 1 Po të keni zgjedhur Kontaktet SIM si default, përzgjidhni nga gatishmëria Menuja ► Kontaktet ► Kontakt i ri ► Shto.
- 2 Futni emrin ► OK.
- 3 Futni numrin ► OK dhe përzgjidhni një mundësi shtesë për numrin. Shtoni të dhëna të tjera, nëse duhet ► Ruaje.

### ***Për t'i ruajtur emrat dhe numrat e telefonit automatikisht në kartën SIM***

- Në qoftë se Kontaktet telef. është cilësuar si default, nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Të avancuara ► Vetëruaj në SIM dhe përzgjidhni Aktivizoje.

## Gjendja e kujtesës

Se sa kontakte mund të ruani në telefon ose në kartën SIM, kjo varet nga kujtesa e përdorshme.

### *Për të parë gjendjen e kujtesës*



- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** ► **Të tjera** ► **Shtesa** ► **Të avancuara** ► **Gjendja kujtesës**.

## Përdorimi i kontakteve

Kontaktet mund të përdoren në shumë mënyra. Në vijim do të mësoni si:



- T'u telefononi kontakteve në telefon dhe në SIM.
- T'ia dërgoni kontaktet në telefon një pajisjeje tjetër.
- T'i kopjoni kontaktet në telefon dhe në kartën SIM.
- T'i bashkëlidhni një foto ose një ton zileje një kontakti.
- Të bëni ndryshime në kontaktet.
- T'i sinkronizoni kontaktet.

### *Për t'i telefonuar një kontakti telefonik*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet**. Shkoni te kontakti, ose futni shkronjën ose shkronjat e para të emrit.
- 2 Kur të përshenjohet kontakti, shtypni  ose  për të përzgjedhur një

numër ► **Telefono** për të bërë një telefonatë zanore, ose ► **Të tjera** ► **Bëj telef. video** për të bërë një telefonatë video.

### *Për t'i telefonuar një kontakti SIM*

- Në qoftë se **Kontaktet SIM** është default, nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** dhe kur të jetë përshenjohet kontakti, shtypni  ose  për të përzgjedhur një numër.
- **Telefono** për të bërë një telefonatë zanore, ose ► **Të tjera** ► **Bëj telef. video** për të bërë një videotelefonatë.
- Në qoftë se **Kontaktet telef.** është cilësuar si default, nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** ► **Të tjera** ► **Shtesa** ► **Kontaktet SIM** dhe përzgjidhni kontaktin ► **Telefono** për të bërë një telefonatë zanore, ose ► **Të tjera** ► **Bëj telef. video** për të bërë një videotelefonatë.

### *Për ta dërguar një kontakt*

- ► **Kontaktet** dhe përzgjidhni një kontakt ► **Të tjera** ► **Dërgo kontaktin** dhe përzgjidhni një mënyrë transferimi.

### *Për t'i dërguar të gjitha kontaktet*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** ► **Të tjera** ► **Shtesa** ► **Të avancuara** ► **Dërgo gjith kontakt** dhe përzgjidhni një mënyrë transferimi.

### ***Për të kopjuar emra dhe numra në kartën SIM.***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** ► **Të tjera** ► **Shtesa** ► **Të avancuara** ► **Kopjo në SIM**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.



*Kur po i kopjoni të gjitha kontaktet nga telefoni në kartën SIM, të gjitha të dhënat ekzistuese në kartën SIM do të zëvendësohen.*

### ***Për të kopjuar emra dhe numra në kontaktet telefonike***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** ► **Të tjera** ► **Shtesa** ► **Të avancuara** ► **Kopjo nga SIM**.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë.

### ***Për t'i shtuar një foto, ton zileje ose video një kontakti në telefon***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** dhe përzgjidhni kontaktin ► **Të tjera** ► **Ndrysho kontakt**.
- 2 Shkoni te kartela përkatëse dhe pastaj përzgjidhni **Foto** ose **Toni i ziles** ► **Shto**.
- 3 Përzgjidhni një mundësi shtesë dhe një objekt ► **Ruaje**.



*Në qoftë se pajtimtaria juaj e përballon shërbimin e Identifikimit të Linjës Telefonuese (CLI), mund t'u bashkëlidhni kontakteve tone zilesh personale.*

### ***Për ta ndryshuar një kontakt në telefon***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** dhe përzgjidhni një kontakt ► **Të tjera** ► **Ndrysho kontakt**.
- 2 Shkoni te kartela përkatëse dhe përzgjidhni një fushë për të ndryshuar ► **Ndrysho**.
- 3 Ndryshojini të dhënat ► **Ruaje**.

### ***Për ta ndryshuar një kontakt SIM***

- 1 Po të keni zgjedhur **Kontaktet SIM** si default, nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** dhe përzgjidhni emrin dhe numrin për të ndryshuar. Po të keni zgjedhur **Kontaktet telef.** si default, nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** ► **Kontaktet** ► **Të tjera** ► **Shtesa** ► **Kontaktet SIM** dhe përzgjidhni emrin dhe numrin për të ndryshuar.
- 2 ► **Të tjera** ► **Ndrysho kontakt**. dhe ndryshoni emrin dhe numrin.

## **Sinkronizimi i kontakteve**

Kontaktet mund t'i sinkronizoni me një aplikacion për kontakte në Internet. Për të dhëna të mëtejshme ► **74 Sinkronizimi**.

### ***Për të ruajtur dhe rikthyer kontaktet me anë të një karte kujtese***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Të avancuara ► Arkivo në M.S. ose Rikthe nga M.S.

### ***Për të caktuar rendin e kontakteve***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Të avancuara ► Radha e renditjes.

## **Lista e telefonatave**

Të dhëna për telefonatat që keni bërë së fundi.

### ***Për t'i telefonuar një numri nga lista e telefonatave***

- 1 Nga gatishmëria, ► Tlfonata dhe përzgjidhni një kartelë.
- 2 Shkoni te emri ose numri të cilit do t'i telefononi ► Telefono për të bërë një telefonatë zanore, ose ► Të tjera ► Bëj telef. video për të bërë një videotelefonatë.

### ***Për të shtuar në kontaktet një numër nga lista e telefonatave***

- 1 Nga gatishmëria, ► Tlfonata dhe përzgjidhni një kartelë.
- 2 Shkoni te numri që do të shtoni ► Të tjera ► Ruaje numrin.

- 3 ► Kontakt i ri për të krijuar një kontakt të ri, ose përzgjidhni një kontakt ekzistues ku ta shtoni numrin.

### ***Për ta fshirë përmbajtjen e listës***

- ► Tlfonata ► kartela ► të gjitha ► Të tjera ► Fshiji të gjitha.

## **Telefonimi i shpejtë me foto**

Numrat e telefonit që i përdorni më shpesh mund t'i ruani në pozicionet 1-9 në telefon. Telefonimi i shpejtë varet nga kontaktet tuaja default ► **25 Kontakti default**. Për shembull, mund të kryeni telefonim të shpejtë me numrat që keni ruajtur në kartën SIM.

Po t'u bashkëlidhni kontakte me foto pozicioneve të telefonimit të shpejtë, fotot e kontakteve do të afishohen për të lehtësuar referimin ► **28 Për t'i shtuar një foto, ton zileje ose video një kontakti në telefon**.

### ***Për të ndryshuar numrat e telefonimit të shpejtë***


- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Telefonim shpejtë.
- 2 Shkoni te pozicioni ► Shto ose ► Të tjera ► Zëvendësoje.

### *Për telefonim të shpejtë*


- Nga gatishmëria, futni numrin rendor ► Telefono.

### **Posta zanore**

Në qoftë se pajtimtaria juaj parashikon shërbim mesazherie, telefonuesit mund të lënë një mesazh në postën zanore sa herë që ju s'arrini t'i përgjigjeni një telefonate.

 Lidhuni me operatorin e rjetit për t'i marrë numrin e postës zanore ose për të marrë të dhëna të mëtejshme.

### **Për t'i telefonuar shërbimit të postës zanore**

- Shtypni për pak çaste . Po të mos keni futur numër të postës zanore në telefon, ► Po dhe futeni numrin.

### **Për ta ndryshuar numrin e postës zanore**

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Cilësimet ► No.postës.zanore.

### **Komandimi zanor**



Mund t'i administroni telefonatat duke krijuar komanda zanore për:

- Telefonim zanor – telefonojini dikujt duke ia shqiptuar emrin.
- Aktivizim të komandimit zanor duke shqiptuar një «fjalë magjike».
- Përgjigje ose refuzim telefonatash kur po përdorni një sistem telefonimi pa duar.

### **Para se të kryeni telefonim zanor**

Aktivizoni funksionin e telefonimit zanor dhe regjistroni komandat tuaja zanore. Një ikonë do të afishohet përbri çdo numri telefoni të cilit i është bashkëlidhur një komandë zanore.

### **Për të aktivizuar telefonimin zanor dhe regjistruar emra**

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Komandimi zanor ► Telefonim zanor ► Aktivizoje ► Po ► Kmn.d. e re zanore dhe përzgjidhni një kontakt.
- 2 Në qoftë se kontakti ka më shumë se një numër, përdorni  dhe  për t'i parë numrat. Përzgjidhni një numër për t'ia bashkëlidhur komandën zanore. Regjistroni një komandë zanore, të tillë si «Elona celular».

- 3 Do të afishohen udhëzime. Prisi të dëgjoni tonin dhe shqiptojeni komandën për ta regjistruar. Komanda zanore do t'ju riprodhohet.
- 4 Po t'ju pëlqejë regjistrimi ► Po. Përndryshe ► Jo dhe përsëritni etapën 3.
- 5 Për të regjistruar një tjetër komandë zanore për një kontakt ► Kmnd. e re zanore ► Shto edhe një herë, pastaj përsitni etapat 2-4 më sipër.

### Emri i telefonuesit

Dëgjoni emrin e regjistruar të kontaktit kur t'ju mbërrijë një telefonatë nga ai kontakt.

### *Për ta aktivizuar ose çaktivizuar emrin e telefonuesit*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Komandimi zanor ► Ripr.emrin tlfonusit.

### Telefonimi zanor

Niseni telefonimin zanor nga gatishmëria duke përdorur telefonin, një sistem portativ pa duar, një kufje Bluetooth ose duke thënë fjalën magjike.

### *Për të bërë një telefonatë*

- 1 Nga gatishmëria, mbani të shtypur një prej tasteve të volumit.
- 2 Prisi të dëgjoni tonin dhe thoni një emër të regjistruar, për shembull «Elona celular». Emri do t'ju riprodhohet, pastaj do të kryhet telefonata.

### *Për kryer një telefonatë duke përdorur sistemin e telefonimit pa duar*

- Nga gatishmëria, mbani të shtypur butonin e sistemit pa duar, ose shtypni butonin e kufjes Bluetooth.

### Fjala magjike

Regjistroni dhe përdorni një komandë zanore si fjalë magjike për të aktivizuar komandimin zanor pa qenë nevoja të shtypni ndonjë tast. Fjala magjike mund të përdoret vetëm me një sistem portativ pa duar.



*Zgjidhni ndonjë fjalë ose frazë të gjatë e të pazakonshme, që mund të dallohet lehtë prej të folurit të zakonshëm në sfond.*

## ***Për të aktivizuar dhe regjistruar fjalën magjike***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Komandimi zanor ► Fjala magjike ► Aktivizoje.
- 2 Do të afishohen udhëzime. ► Vazhdo. Prisi të dëgjoni tonin dhe shqiptojeni fjalën magjike.
- 3 ► Po për ta pranuar ose ► Jo për të regjistruar një fjalë të re magjike.
- 4 Do të afishohen udhëzime. ► Vazhdo dhe përzgjidhni mjediset ku duhet aktivizuar fjala magjike.

## **Përgjigjja zanore**

Përgjigjuni telefonatave ose refuzojini me anë komandash zanore, kur po përdorni një sistem telefonimi pa duar.



*Mund të përdorni skeda MIDI, WAV (16 kHz), eMelody ose iMelody si tone ziles me përgjigjen zanore.*

## ***Për të aktivizuar përgjigjen zanore dhe regjistruar komanda të përgjigjes zanore.***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Komandimi zanor ► Përgjigje zanore ► Aktivizoje.
- 2 Do të afishohen udhëzime. ► Vazhdo. Prisi të dëgjoni tonin dhe thoni «Përgjigju» ose ndonjë fjalë tjetër.

- 3 ► Po për ta pranuar ► Jo për ta regjistruar prapë.
- 4 Do të afishohen udhëzime. ► Vazhdo. Prisi të dëgjoni tonin dhe thoni «I zënë» ose ndonjë fjalë tjetër.
- 5 ► Po për ta pranuar ► Jo për ta regjistruar prapë.
- 6 Do të afishohen udhëzime. ► Vazhdo dhe përzgjidhni mjediset ku duhet aktivizuar përgjigjja zanore.

## ***Për t'iu përgjigjur një telefonate ose për ta refuzuar me anë komandash zanore***

- Kur të bjerë zilja, thoni:
  - «Përgjigju», për ta lidhur telefonatën.
  - «I zënë», për ta refuzuar telefonatën.

## ***Për t'i ndryshuar komandat tuaja zanore***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet dhe shkoni te një kontakt.
- 2 ► Të tjera ► Ndrysho kontakt. dhe shkoni te kartela përkatëse.

## ***Për ta regjistruar përsëri një komandë zanore***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Komandimi zanor ► Telefonim zanor ► Ndrysho emrat.
- 2 Përzgjidhni një komandë ► Të tjera ► Zëv. kom. zanore.
- 3 Prisi të dëgjoni tonin dhe shqiptojeni komandën.





## Devijimi i telefonatave

Telefonatat mund t'i devijoni drejt, për shembull, një mesazherie.



*Kur funksioni i bllokimit të telefonatave është aktiv, disa shtesa të devijimit nuk mund të përdoren. ► 35 Bllokimi i telefonimit.*

Telefoni ju ofron mundësitë shtesë të mëposhtme:

- Gjithnjë devijo – të gjitha telefonatat.
- Kur i zënë – nëse ka një telefonatë në vazhdim.
- I pagjendshëm – kur telefoni është i fikur ose i pagjetshëm.
- Kur s'përgjigjesh – kur telefonata mbetet pa përgjigje për një kohë të caktuar.

### *Për të aktivizuar një devijim*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Tlfonata ► Devijo telefonatat.
- 2 Përzgjidhni një lloj telefonate dhe një mundësi shtesë devijimi ► Aktivizoje.
- 3 Futeni numrin e telefonit drejt të cilit do t'i devijoni telefonatat, ose shtypni Kërkoje për të gjetur një kontakt ► OK.

### *Për ta çaktivizuar një devijim*

- Shkoni te mundësia shtesë e devijimit ► Çaktivizoje.

## Disa telefonata njëkohësisht

Trajtoni më shumë se një telefonatë njëkohësisht.



### Shërbimi i telefonatës në ardhje

Kur kjo është aktive, do të dëgjoni një bip sa herë t'ju mbërrirë një telefonatë e dytë.

### *Për ta aktivizuar ose çaktivizuar shërbimin e telefonatës në ardhje*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Tlfonata ► Trajto telefonatat ► Telef. në ardhje.

### *Për të bërë një telefonatë të dytë*

- 1 ► Të tjera ► Në pritje për ta vënë në pritje telefonatën aktive.
- 2 Futeni numrin për t'i telefonuar ► Të tjera ► Telefono.

### *Për të marrë një telefonatë të dytë zanore*

- Kur ju mbërrin një telefonatë e dytë, ju mund:
  - ► Përgjigju dhe ta vini në pritje telefonatën në vazhdim.
  - ► I zënë për ta refuzuar dhe për të vazhduar me telefonatën e parë.
  - ► Zvnds. telef.aktive për t'iu përgjigjur dhe për ta përfunduar telefonatën e parë.



## **Për të trajtuar dy telefonata zanore**

Kur keni një telefonatë në vazhdim dhe një në pritje, ju mund të:

- ▶ Të tjera për mundësi shtesë:
  - Këmbeji – këmbehuni midis dy telefonatave.
  - Bashkoji telef. – bashkojini dy telefonatat.
  - Transfero telef. – lidhini dy telefonatat së bashku. Ju vetë do të shkëputeni si nga njëra ashtu edhe nga tjetra.
- ▶ Mbaroje për mundësi shtesë:
  - Po – kthehuni te telefonata në pritje.
  - Jo – përfundojini të dy telefonatat.

Nuk mund t'i përgjigjeni një telefonate të tretë pa përfunduar një prej dy të parave ose pa i bashkuar këto në një telefonatë konferencë.

## **Konferencat**

Niseni një telefonatë konferencë duke bashkuar një telefonatë në vazhdim dhe një telefonatë në pritje. Gjithashtu mund ta vini konferencën në pritje dhe të shtoni atje deri në pesë pjesëmarrës ose të kryeni një telefonatë tjetër.



*Telefonatat me palë të shumëfishta mund t'ju faturohen ndryshe; lidhuni me operatorin e rrjetit për të dhëna të mëtejshme.*

### ***Për t'i bashkuar dy telefonatat në një konferencë***

- ▶ Të tjera ▶ Bashkoji telef.

### ***Për të shtuar një pjesëmarrës të ri***

- 1 ▶ Të tjera ▶ Në pritje për t'i vënë në pritje telefonatat që keni bashkuar.
- 2 ▶ Të tjera ▶ Bëj telefon. tjetër dhe telefonojini personit tjetër që dëshironi të futni në konferencë.
- 3 ▶ Të tjera ▶ Bashkoji telef.
- 4 Përsëritni etapat 1–3 për të shtuar pjesëmarrës të tjerë.

### ***Për të liruar një pjesëmarrës***

- ▶ Të tjera ▶ Liroje palën dhe përzgjidhni pjesëmarrësin që do të lironi nga konferenca.

### ***Për të kryer një bisedë private***

- 1 ▶ Të tjera ▶ Fol me dhe përzgjidhni pjesëmarrësin me të cilin dëshironi të flisni veçmas.
- 2 ▶ Të tjera ▶ Bashkoji telef. për t'u kthyer në konferencë.



## Dy linja zanore

Në qoftë se pajtimtaria juaj e përballon shërbimin e Linjave alternative, mund të bëni telefonata duke përdorur numra të ndryshëm telefoni.

### *Për të përzgjedhur një linjë për telefonata në dalje*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Tlfonata. Përzgjidhni një linjë.

### *Për t'ia ndërruar emrin një linje*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Ekranit ► Ndrysho.em.linjave. Përzgjidhni linjën që do të ndryshoni.

## Numrat e mi

Numrat tuaj të telefonit mund t'i shihni, t'i futni dhe t'i ndryshoni.

### *Për të parë numrat tuaj të telefonit*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Numra specialë ► Numrat e mi dhe përzgjidhni një nga mundësitë shtesë.

## Pranimi i telefonatave

Mund të cilësoni që t'ju mbërrijnë telefonata vetëm nga disa numra. Po të jetë aktivizuar mundësia shtesë e devijimit Kur i zënë, telefonatat do të devijohen.

### *Për t'i shtuar numra listës së telefonuesve të pranuar*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Tlfonata ► Trajto telefonatat ► Pranim telefonata ► Vetëm nga lista ► Ndrysho ► Shto.
- 2 Përzgjidhni një kontakt ose ► Grupet ► 38 Grupet.

### *Për t'i pranuar të gjitha telefonatat*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Tlfonata ► Trajto telefonatat ► Pranim telefonata ► Gjith tlfonuesit.



## Bllokimi i telefonimit

Mund t'i bllokoni telefonatat, edhe në hyrje edhe në dalje. Për këtë ju duhet një fjalëkalim, që do t'ju japë ofruesi i shërbimit.



*Në rast se i devijoni telefonatat në hyrje, nuk mund t'i aktivizoni disa mundësi shtesë të bllokimit.*

Mund të bllokohen telefonatat e llojeve të mëposhtme:

- Të gjitha në dalje – të gjitha telefonatat në dalje.
- Ndërk. në dalje – të gjitha telefonatat ndërkombëtare në dalje.
- Ndërk.dalje.road. – të gjitha telefonatat ndërkombëtare në dalje me përjashtim të atyre në vendin tuaj.
- Të gjitha në hyrje – të gjitha telefonatat në hyrje.
- Edhe kur roaming – të gjitha telefonatat në hyrje kur jeni jashtë shtetit ➤ 21 Rrjetet.

### ***Për ta aktivizuar ose çaktivizuar një bllokim telefonate***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Tlfonata ► Trajto telefonatat ► Blloko telefonata. Përzgjidhni një mundësi shtesë.
- 2 Përzgjidhni Aktivizoje ose Çaktivizoje, futni fjalëkalimin ► OK.



## **Telefonimi fiks**

Funksioni i telefonimit fiks lejon që t'u telefonohet vetëm disa numrave të caktuar, që ruhen në kartën SIM. Numrat fiks mbrohen me kodin PIN2.



*Edhe kur funksioni i telefonimit fiks është aktiv, përsëri mund t'i telefononi numrit ndërkombëtar të urgjencës 112.*

Mund të ruani edhe numra të pjesshëm. Për shembull, po të ruani 0123456 do të mund t'i telefononi çdo numri që nis me 0123456.



*Kur funksioni i telefonimit fiks është aktiv, mund të mos ju lejohet të shihni ose të administroni numra telefoni që ruhen në kartën SIM.*

### ***Për ta aktivizuar ose çaktivizuar telefonimin fiks***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Numra specialë ► Telefonimi fiks dhe përzgjidhni Aktivizoje ose Çaktivizoje.
- 2 Futni kodin PIN2 ► OK pastaj ► OK përsëri, për ta konfirmuar.

### ***Për të ruajtur një numër fiks***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Numra specialë ► Telefonimi fiks ► Numrat fiks ► Numër i ri dhe futni të dhënat.



## Kohëzgjatja dhe kostoja e telefonatave

Gjatë telefonimit, do të afishohet kohëzgjatja e telefonatës. Mund të shihni kohëzgjatjen e telefonatës së fundit, telefonatave në dalje dhe kohëzgjatjen gjithsej të telefonatave.

### *Për të kontrolluar kohëzgjatjen*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Telefonatat ► Kohzgj. & Kosto ► Kohëmatësit.

## Funksione të tjera të telefonimit

### Sinjalet e toneve

Kur jeni duke kryer një telefonatë, mund të përdorni shërbime bankare telefonike ose të komandoni një mesazheri telefonike duke dërguar sinjale tonesh.

### *Për të përdorur sinjale tonesh*

- Shtypni **(0+)** - **(9)**, **(\*)** ose **(#)** për të dërguar tone.
- Të tjera ► Çaktivizo tonet ose Aktivizo tonet për t'i ndezur ose fikur tonet gjatë një telefonate.
- Shtypni **(C)** për ta fshirë përmbajtjen e ekranit pas një telefonate.

### Blloku i shënimeve

Përdoreni telefonin si bllok shënimesh, për të mbajtur shënim një numër telefoni gjatë një telefonate. Kur e përfundoni telefonatën, numri do të mbetet në ekran dhe ju mund t'i telefononi ose ta ruani në kontaktet.

### *Për t'i telefonuar një numri nga blloku i shënimeve ose për ta ruajtur*

- ► Telefono për t'i telefonuar numrit.
- ► Të tjera ► Ruaje numrin dhe përzgjidhni një kontakt për t'ia bashkëlidhur numrin.
- ► Të tjera ► Kontakt i ri për të krijuar një kontakt të ri që t'i bashkëlidhet numrit.

### Për ta treguar ose për ta fshehur numrin tuaj

Në rast se pajtimtaria juaj e përballon shërbimin e Bllokimit të Identifikimit të Linjës Telefonuese (CLIR), ju mund ta fshihni numrin tuaj, kur po bëni një telefonatë.

### *Për ta treguar ose për ta fshehur numrin tuaj gjithnjë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Telefonatat ► Afisho/fshih num.
- 2 Përzgjidhni Tregoje numrin, Fshihe numrin ose Default rrjeti.

## Grupet

Krijoni një grup numrash dhe adresash PE për t'u dërguar mesazhe disa marrësve njëkohësisht

➡ 39 Mesazhimi.



*Po t'i dërgoni një mesazh shkrimor një grupi, do të faturoheni veçmas për çdo pjesëtar të grupit.*

Grupet gjithashtu mund t'i përdorni (me numra) kur krijoni lista telefonuesish të pranuar ➡ 35 Pranimi i telefonatave.

### *Për të krijuar një grup numrash dhe adresash PE*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Grupet ► Grup i ri ► Shto.
- 2 Vëri një emër grupit ► Vazhdo.
- 3 ► I ri ► Shto për të gjetur dhe përzgjedhur një numër kontakti ose adresë PE.
- 4 Përsëriteni etapën 3 për të shtuar numra dhe adresa PE të tjera.  
► Mbarova.

## Kartëvizitat

Shtojeni kartëvizitën tuaj si kontakt.

### *Për të shtuar kartëvizitën tuaj*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Kartëvizita ime dhe shtoni të dhëna për kartëvizitën ► Ruaje.

### *Për të dërguar kartëvizitën tuaj*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet ► Të tjera ► Shtesa ► Kartëvizita ime ► Drgo kartëvizitën dhe përzgjidhni një mënyrë transferimi.

# Mesazhimi

*Mesazhimi shkrimor, mesazhimi-figurë, mesazhimi zanor, posta elektronike (PE), Shokët e mi.*

Telefoni juaj përballon shërbime të ndryshme mesazhimi. Lidhuni me ofruesin e shërbimit për të mësuar se ç'shërbime mund të përdorni ose, për të dhëna të mëtejshme, shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

## Mesazhimi shkrimor (SMS)

Mesazhet shkrimore mund të përmbajnë edhe foto të thjeshta, efekte zanore, animacione dhe melodi. Mund edhe të krijoni dhe të përdorni modele për mesazhet tuaja.

### Para se të filloni

Numrin e qendrës suaj të shërbimit jua jep ofruesi i shërbimit dhe zakonisht gjendet i regjistruar në kartën SIM. Përndryshe mund ta futni ju vetë.

### *Për të cilësuar një numër të qendrës së shërbimit*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Cilësimet ► Mszh shkrimor ► Qendra e shërbimit. Në qoftë se numri i qendrës së shërbimit ruhet në kartën SIM, do të afishohet.

- 2 Po të mos afishohet ndonjë numër ► Ndrysho ► QendërReShërbimi dhe futeni numrin, pa harruar prefiksën ndërkombëtar «+» dhe kodin e shtetit/rajonit ► Ruaje.


### **Për të dërguar mesazhe shkrimore**


Për të dhëna në lidhje me futjen e shkronjave ► 17 Për të futur shkronja.







*Disa shenja specifike për gjuhë të caktuara zënë më shumë vend në mesazh. Për disa gjuhë mund t'i çaktivizoni Shkronja speciale për të kursyer vend.*

### **Për të shkruar dhe dërguar një mesazh shkrimor**

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Krijo të ri ► Mszh shkrimor.
- 2 Shkruajeni mesazhin ► Vazhdo. (Mund ta ruani mesazhin për më vonë në Skica duke shtypur  ► Ruaje mesazhin.)
- 3 ► Fut no. e telef. dhe futni një numër, ose ► Gjeje në Kontaktet për ta përnxjerrë numrin ose grupin nga Kontaktet, ose ► Fut adresën PE ose për të përzgjedhur ndonjë nga marrësit që keni përdorur së fundi ► Dërgoje.


 Për t'i dërguar mesazh një adrese PE, duhet të cilësoni një numër të rrugëhyrjes PE, ► Mesazhimi ► Cilësimet ► Mszh shkrimor ► Rrugëhyrja PE. Këtë numër ju ja jep ofruesi i shërbimit.

### ***Për të kopjuar dhe ngjitur tekst në një mesazh***


- 1 Kur po e shkruani mesazhin ► Të tjera ► Kopjo & ngjit.
- 2 ► Kopjo të gjitha ose ► Shenjo & kopjo dhe shtypni , ,  dhe  për të lundruar dhe për të shenjuar tekst në mesazh.
- 3 ► Të tjera ► Kopjo & ngjit ► Ngjite.

### ***Për të futur një objekt në një mesazh shkrimor***

- 1 Kur po e shkruani mesazhin ► Të tjera ► Shto objekt.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë, pastaj një objekt, për shembull një foto.

 Mesazhin shkrimor mund ta konvertoni në mesazh-figurë. Kur po e shkruani mesazhin ► Të tjera ► Në mesazh-figurë dhe vijoni të krijoni një mesazh-figurë, ► 42 Mesazhimi-figurë (MMS).

**Për të marrë mesazhe shkrimore**  
Kur po ju mbërrin një mesazh shkrimor, do të afshohet në menunë e veprimeve nëse funksioni Ngjarje të reja është cilësuar si Menu veprimesh. ► Shih për ta lexuar mesazhin.

Në qoftë se funksioni Ngjarje të reja është cilësuar si Pop-up, do t'ju kërkohet nëse dëshironi ta lexoni mesazhin shkrimor. ► Po për ta lexuar mesazhin ose ► Jo për ta lexuar më vonë. Kur ta keni lexuar mesazhin shkrimor ► Të tjera për mundësi shtesë ose shtypni  për ta mbyllur mesazhin.

### ***Për t'i telefonuar një numri në një mesazh shkrimor***

- Përzgjidhni numrin e telefonit të afishuar në mesazh, ► Telefono.

### ***Për të ruajtur dhe fshirë mesazhe shkrimore***

Mesazhet shkrimore që ju mbërrijnë ruhen në kujtesën e telefonit. Kur të mos ketë më vend në kujtesën e telefonit, fshini mesazhe ose kalojini në kartën SIM që të mund të merrni të reja. Mesazhet që keni ruajtur në kartën SIM do të mbeten atje deri sa t'i fshini ju vetë.




### ***Për të ruajtur një mesazh***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Kutia në hyrje dhe përzgjidhni një mesazh për të ruajtur.
- 2 ► Të tjera ► Ruaje mesazhin.
- 3 ► Mesazhe ruajtur për ta ruajtur në kartën SIM ose ► Modelet për ta ruajtur mesazhin si model në telefon.

### ***Për të ruajtur një objekt në një mesazh shkrimor***

- 1 Kur po lexoni një mesazh, përzgjidhni numrin e telefonit, foton ose adresën e Internetit që dëshironi të ruani ► Të tjera.
- 2 ► Përdore (do të afishohet numri i telefonit që keni përzgjedhur) ► Ruaje numrin për ta ruajtur numrin e telefonit ose ► Ruaje foton për të ruajtur një foto ose ► Përdore (do të afishohet kujtesorja që keni përzgjedhur) ► Ruaje kujtesoren për të ruajtur një kujtesore.

### ***Për të fshirë një mesazh***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi dhe përzgjidhni një regjistër.
- 2 Përzgjidhni mesazhin për të fshirë dhe shtypni .

### ***Për të ruajtur ose fshirë disa mesazhe njëkohësisht***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi dhe përzgjidhni një regjistër.
- 2 Përzgjidhni një mesazh ► Të tjera ► Fshij gjith meszh për t'i fshirë të gjitha mesazhet në regjistër ose ► Shenjo disa lundroni dhe përzgjidhni mesazhe duke shtypur Shenjo ose Çshenjoje.
- 3 ► Të tjera ► Ruaj mesazhet për të ruajtur mesazhe ose ► Fshiji mesazhet për të fshirë mesazhe.

### ***Mesazhet e gjata***

Se sa shkronja lejohen në një mesazh shkrimor, kjo varet nga gjuha që po përdorni për të shkruar. Mund të dërgoni një mesazh të gjatë duke lidhur së bashku dy ose më shumë mesazhe. Do të faturoheni veçmas për secilin prej mesazheve pjesë të mesazhit të gjatë. Pjesët e një mesazhi të gjatë mund të mos i mbërrijnë marrësit njëkohësisht.



*Pyesni ofruesin e shërbimit për numrin maksimal të mesazheve që mund të lidhen së bashku.*

### ***Për ta aktivizuar funksionin e mesazheve të gjata***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Cilësimet ► Mszh shkrimor ► Gjat.max.mesazhit ► Max. i përdorsh.

### **Modelet për mesazhe shkrimore**

Shtoni një model të ri ose ruajeni një mesazh si model në telefon  
► **41 Për të ruajtur një mesazh.**

### ***Për të shtuar një model***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Modelet ► Model i ri ► Tekst.
- 2 Futni tekst ► OK.
- 3 Futni një titull ► OK.

### ***Për të përdorur një model***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Modelet përzgjidhni një model ► Përdore ► Mszh shkrimor.
- 2 Shtoni tekst ose ► Vazhdo dhe përzgjidhni një marrës të cilit t'ia dërgoni mesazhin.

### **Mundësitë shtesë të mesazheve**

Cilësoni një vlerë default për mundësitë shtesë të mesazheve, ose zgjidhni cilësimet sa herë që dërgoni një mesazh.

### ***Për të cilësuar mundësi shtesë default për mesazhet shkrimore***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Cilësimet ► Mszh shkrimor dhe përzgjidhni mundësitë shtesë që do të ndryshoni.

### ***Për të cilësuar mundësi shtesë për një mesazh të caktuar***

- 1 Pasi ta keni shkruar mesazhin dhe të keni caktuar marrësin ► Të tjera ► Të avancuara.
- 2 Përzgjidhni një mundësi shtesë për të ndryshuar ► Ndrysho dhe përzgjidhni një cilësim të ri ► Mbarova.

### ***Për të kontrolluar statusin e dorëzimit të një mesazhi që keni dërguar***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Mszhe dërguar dhe përzgjidhni një mesazh shkrimor ► Shih ► Të tjera ► Shih gjendjen.

### **Mesazhimi-figurë (MMS)**

Mesazhet-figurë mund të përmbajnë tekst, imazhe, foto të kameras, diapozitiva, regjistrime zanore, videoklipe, firma dhe shtojca. Mund t'i dërgoni mesazhe-figurë një telefoni celular ose një adresë PE.

## Para se të filloni


Edhe ju edhe marrësi duhet të keni pajtimtari të tilla që ta përballojnë mesazhimin-figurë.

Po të mos ekzistojë as profil Interneti as server për mesazhet, mund t'i merrni të gjitha cilësimet MMS automatikisht nga operatori i rjetit ose nga [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

Para se të dërgoni një mesazh-figurë, mund të kontrolloni nëse:

Janë cilësuar adresa e serverit të mesazheve dhe një profil Interneti. Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Cilësimet ► Mesazh-figurë ► Profili MMS dhe përzgjidhni një profil për ta përdorur. ► Të tjera ► Ndrysho ► Serveri i mszheve ose ► Të tjera ► Ndrysho ► Profili Internet.

## *Për të krijuar dhe për të dërguar një mesazh-figurë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Krijë të ri ► Mesazh-figurë.
- 2 Shtypni  për të shtuar objekte të tilla si foto, videoklipe ose skeda zanore.  
► Të tjera për të parë një listë mundësish të tjera shtesë.
- 3 Kur të jeni gati për të dërguar ► Vazhdo.

- 4 ► Fut adresën PE ose ► Fut no. e telef. ose ► Gjeje në Kontaktet për të përnxjerrë një numër ose grup në Kontaktet ose të përzgjidhni nga marrësit që keni përdorur së fundi ► Dërgoje.



*Kur shkruani dhe ndryshoni mesazhe-figurë, mund të kopjoni dhe të ngjitni tekst ► 40 Për të kopjuar dhe ngjitur tekst në një mesazh.*

## *Për të krijuar një firmë tuajën për mesazhe-figurë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Cilësimet ► Mesazh-figurë.
- 2 ► Firma ► Firmë e re dhe krijojeni firmën tuaj si mesazh-figurë.

## *Për të cilësuar mundësi shtesë default për mesazhet-figurë*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Cilësimet ► Mesazh-figurë dhe përzgjidhni mundësi shtesë që do të ndryshoni.

**Mundësi të tjera shtesë për dërgimin**  
Kërkoni një raport leximi, një raport dorëzimi dhe cilësoni shkallën e përparësisë për një mesazh të caktuar. Mund edhe t'i shtoni marrës të tjerë mesazhit.

## ***Për të përzgjedhur mundësi të tjera shtesë për dërgimin***

- 1 Pasi ta keni krijuar mesazhin dhe të keni përzgjedhur një marrës ► **Të tjera.**
- 2 ► **Shto marrës për të shtuar një marrës tjetër ose ► Ndrysho marrësit për të ndryshuar marrësit ose për të shtuar të tjerë. ► Ndrysho subjektin për t'i ndërruar titullin mesazhit ose ► Të avancuara për mundësi shtesë të mëtejshme dërgimi.**


## ***Për të marrë mesazhe-figurë***

Vendosni si do t'i shkarkoni mesazhet-figurë dhe si do t'i ruani objektet që ju vijnë me mesazhet-figurë.

## ***Për të cilësuar shkarkimin automatik***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja ► Mesazhimi ► Cilësimet ► Mesazh-figurë ► Vetëshkarkimi për të parë dhe përzgjedhur një nga sa vijon:**
  - **Gjithnjë** – shkarkim automatik.
  - **Pyet kur roam.** – telefoni kërkon leje për të shkarkuar, kur nuk jeni në rrjetin bazë.
  - **Kurrë kur roam.** – asnjë shkarkim nuk do të kryhet, kur nuk jeni në rrjetin bazë.
  - **Gjithnjë pyet** – për të shkarkuar.
  - **Joaktiv** – mesazhet e reja do të afishohen në kutinë **Kutia në hyrje.** Përzgjidhni mesazhin dhe ► **Shih për të shkarkuar.**


## ***Për të marrë mesazhe-figurë***

- 1 Kur merrni një mesazh-figurë të shkarkuar automatikisht, kjo do të afishohet në menunë e veprimeve në qoftë se funksioni **Ngjarje të reja** është cilësuar si **Menu veprimesh.** ► **Shih** për ta lexuar mesazhin. Në qoftë se funksioni **Ngjarje të reja** është cilësuar si **Pop-up**, do t'ju kërkohet nëse dëshironi ta lexoni mesazhin-figurë, ► **Po** për ta lexuar ose riprodhuar.
- 2 Shtypni  për ta mbyllur mesazhin.

## ***Për të ruajtur një objekt në një mesazh-figurë***

- Kur po shihni një mesazh-figurë ► **Të tjera ► Ruaj objektet** dhe përzgjidhni një objekt për të ruajtur nga lista që afishohet.

## ***Për të fshirë mesazhe-figurë***

Mesazhet-figurë do të ruhen në kujtesën e telefonit. Kur të mos ketë më vend në kujtesën e telefonit, duhet të fshini mesazhe që të mund të merrni të reja. Përzgjidhni një mesazh dhe shtypni  për ta fshirë.

## ***Modelet për mesazhe-figurë***

Shtoni një model të ri ose përdorni një model të paracaktuar.

### *Për të shtuar një model*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Modelet ► Model i ri ► Mesazh-figurë.
- 2 ► Të tjera për të shtuar objekte të reja.
- 3 ► Ruaje, futni një titull ► OK për ta ruajtur modelin.

### *Për të përdorur një model*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Modelet dhe përzgjidhni një model nga lista ► Përdore për ta përdorur modelin siç është ose ► Të tjera ► Ndrysho modelin për t'i bërë ndryshime, ► Ruaje, vëri një titull ► OK për t'i ruajtur ndryshimet.
- 2 ► Vazhdo dhe përzgjidhni një marrës për t'ia dërguar mesazhin ose përzgjidhni një model nga lista ► Përdore ► Vazhdo në qoftë se modelit i bëhen ndryshime.

## **Mesazhet zanore**

Mund të dërgoni dhe të merrni regjistrime zanore në trajtë mesazhesh.



*Dërguesi dhe marrësi duhet të kenë një pajtimtari që e përballon mesazhimin-figurë.*


### *Për të regjistruar dhe dërguar një mesazh zanor*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► Krijo të ri ► Mesazh zanor.
- 2 Regjistrojeni mesazhin tuaj. ► Stop për ta përfunduar.
- 3 ► Dërgoje për ta dërguar mesazhin.
- 4 ► Fut adresën PE për një marrës të postës elektronike ose ► Fut no. e telef. për një numër telefoni marrësi ose ► Gjeje në Kontaktet për një numër ose grup në Kontaktet ose përzgjidhni nga marrësit që keni përdorur së fundi ► Dërgoje.

### **Për të marrë mesazhe zanore**

Kur merrni një mesazh-zanor të shkarkuar automatikisht, mesazhi zanor do të afishohet në menunë e veprimeve në qoftë se funksioni Ngjarje të reja është cilësuar si Menu veprimesh. ► Riprodho për ta dëgjuar mesazhin.

Në qoftë se funksioni Ngjarje të reja është cilësuar si Pop-up, do t'ju kërkohet nëse dëshironi ta dëgjoni mesazhin zanor. ► Po për ta riprodhuar mesazhin ose ► Jo në qoftë se dëshironi ta dëgjoni mesazhin më vonë. Pasi ta keni dëgjuar mesazhin

zanor ► Të tjera për të parë një listë mundësish shtesë. Shtypni  për ta mbyllur mesazhin.



## Posta elektronike

Mesazhet tuaja PE mund t'i lexoni në telefon në çdo kohë. Shkruani një mesazh, bashkëlidhni një foto nga kamera, regjistrim zanor ose videoklip dhe dërgojuani shokëve tuaj ose kolegëve. Mund edhe t'u përgjigjeni mesazheve PE, ose t'ua përcillni të tjerëve, njëjloj sikurse veproni në kompjuter.

Në telefon mund të përdorni po atë adresë PE që përdorni në kompjuter. Për këtë, telefoni juaj kërkon të njëjtat cilësime PE si ato që përdor kompjuteri juaj për adresën tuaj PE. Për të përdorur në telefon adresën tuaj PE të kompjuterit, kryeni një nga veprimet e mëposhtme:

- **Merrini cilësimet automatikisht**  
Rruga më e lehtë është që cilësimet t'ju dërgohen drejtpërdrejt në telefon. Përdorni Internetin, nga kompjuteri, për të shkuar te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

## • Futini cilësimet ju vetë

- Kërkojini ofruesit të shërbimit tuaj PE të dhëna për cilësimet. Ofruesi i shërbimit PE është personi ose kompania që ju ofron adresën PE, për shembull administratori i rrjetit informatik në ndërmarrjen tuaj ose një ofrues i shërbimit Internet, ose
- Ofruesi i shërbimit PE mund t'ju ketë dërguar një dokument me të dhëna për cilësimet, ose
- Të dhënat mund t'i gjeni në cilësimet e programit të postës elektronike në kompjuterin tuaj.

## Çfarë të dhënash më duhen?

Ju duhen së paku:

Llojet e cilësimeve	Shembuj
Tipi i lidhjes	<i>POP3 ose IMAP4</i>
Adresa PE	<i>elona.dibra@ example.com</i>
Serveri në hyrje	<i>mail.example.com</i>
Emri përdoruesit	<i>elonad</i>
Fjalëkalimi	<i>zX123</i>
Serveri në dalje	<i>mail.example.com</i>



*Ka një numër të madh ofruesish të shërbimit PE. Terminologjia e përdorur dhe të dhënat e kërkuara ndryshojnë nga një ofrues në tjetrin. Jo të gjithë ofruesit lejojnë të përdoret PE nga celulari.*

Kur futni cilësimet, mund të përdorni edhe udhëzime konfigurimi dhe të dhëna ndihmëse.

### ***Për t'i futur cilësimet PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Cilësimet.
- 2 Pasi t'i keni futur cilësimet, ► Kutia në hyrje ► Të tjera ► Dërgo & Merr për të përdorur postën elektronike.

Pasi t'i keni futur cilësimet, telefoni juaj mund të lidhet me një server PE për të dërguar dhe marrë mesazhe PE.

Lidhuni me ofruesin e shërbimit PE për të dhëna të mëtejshme.

### ***Për të krijuar një llogari PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Cilësimet ► Llogari e re ► Shto.
- 2 Vëri një emër llogarisë ► OK. Për ndihmë ► Udhëzime konfigur., ose shtypni  për një cilësim ► Info.
- 3 Shtypni  te një cilësim dhe futni cilësimet minimale të kërkuara si më poshtë:

- Sinjalizim PE – përzgjidhni tingullin sinjalizues për mesazhe të reja.
- Lidhu me – dhe përzgjidhni një llogari dhanore (që ju ofrohet nga operatori i rrjetit, ► Info).
- Adresa PE – futni adresën tuaj PE.
- Tipi i lidhjes – POP3 ose IMAP4.
- Serveri në hyrje – futni emrin e serverit.
- Emri përdoruesit – futni emrin e përdoruesit për llogarinë PE.
- Fjalëkalimi – futni fjalëkalimin për llogarinë PE.
- Serveri në dalje – futni emrin e serverit.

### ***Për të futur cilësimet të avancuara të llogarisë PE (fakultative në shumicën e rasteve)***




- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Cilësimet.
- 2 Përzgjidhni një llogari për të ndryshuar ► Të tjera ► Ndrysho llogarinë ► Cilësimet të avanc.
- 3 Shtypni  për të përzgjedhur dhe futur cilësimet, nëse kjo kërkohet nga ofruesi i shërbimit PE, për shembull, Intervali rifreskimimit.

### ***Për të marrë dhe lexuar mesazhe PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Kutia në hyrje ► Drg&Mer kur kutia në hyrje është bosh ose ► Mesazhimi ► PE ► Kutia në hyrje ► Të tjera ► Dërgo & Merr për të shkarkuar mesazhe të reja. Kështu do të dërgohen edhe mesazhe që mund të kenë mbetur në kutinë në dalje.
- 2 Përzgjidhni një mesazh në kutinë në hyrje ► Shih për ta lexuar.

### ***Për të shkruar dhe dërguar një mesazh PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Krijë të ri.
- 2 ► Shto për të hyrë në fushën e marrësit. ► Fut adresën PE për ta shkruar një adresë PE ► OK, ose ► Gjeje në Kontaktet për të përzgjedhur një marrës nga Kontaktet ► Përzgjidh, ose përzgjidhni një adresë të re nga marrësit që keni përdorur së fundi ► Përzgjidh.
- 3 ► Ndrysho për të hyrë në fushën e marrësit (pasi ta keni futur një marrës) që të shtoni marrës të tjerë. Përzgjidhni Merr, Cc ose Bcc dhe përzgjidhni marrësit që do të shtoni. Pasi t'i keni përzgjedhur marrësit ► Mbarova.

- 4 Shtypni  për të përzgjedhur fushën e titullit, vëri një titull mesazhit tuaj ► OK. Për ta ndryshuar titullin ► Ndrysho.
- 5 Shtypni  për të përzgjedhur fushën e tekstit, shkruajeni mesazhin ► OK. Për të bërë ndryshime në mesazh ► Ndrysho.
- 6 Shtypni  për të përzgjedhur fushën e shtojcave. ► Shto dhe zgjidhni llojin e shtojcës që do të bashkëlidhni ► Përzgjidh për ta përzgjedhur shtojcën që do të bashkëlidhni. Për të bashkëlidhur shtojca të tjera ► Shto përsëri.
- 7 ► Vazhdo ► Dërgoje ose Të tjera ► Ruaj në Kut.dalje për të ruajtur dhe dërguar më vonë.



*Kur shkruani dhe ndryshoni mesazhe PE, mund të kopjoni dhe të ngjitni tekst*  
► 40 Për të kopjuar dhe ngjitur tekst në një mesazh.

### ***Për të ruajtur një mesazh PE***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Kutia në hyrje.
- 2 Përzgjidhni një mesazh ► Të tjera ► Ruaje mesazhin ► PE të ruajtura.



### ***Për t'iu përgjigjur një mesazhi PE***

- 1 Përzgjidhni në kutinë në hyrje mesazhin të cilit do t'i përgjigjeni ► Të tjera ► Përgjigju ose hapeni mesazhin ► Përgjigju.
- 2 ► Po për ta përfshirë tekstin e mesazhit origjinal në përgjigjen tuaj ose ► Jo për ta lënë mesazhin origjinal jashtë tekstit të përgjigjes suaj.
- 3 Shkruajeni mesazhin në fushën e tekstit ► OK. Për të bërë ndryshime në mesazh ► Ndrysho.
- 4 ► Vazhdo ► Dërgoje.

### ***Për të parë ose ruajtur një shtojcë në një mesazh PE***

- Shihni një mesazh ► Të tjera ► Shtojcat ► Shih për ta parë objektin ose për të përzgjedhur një objekt për ta ruajtur.

### **Llogaria PE aktive**

Në qoftë se keni disa llogari PE, mund të vendosni se cila do të jetë aktive.

### ***Për ta ndryshuar llogarinë PE aktive***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Cilësimet dhe përzgjidhni një llogari.

### **PE Push**

Merrni një njoftim në telefon nga serveri juaj PE se keni postë të re elektronike, nëse këtë e përballon ofruesi i shërbimit tuaj PE.

### ***Për ta aktivizuar njoftimin PE Push***

- Kur përdorni Dërgo & Merr, ► Po për ta aktivizuar, nëse ju kërkohet.
- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Cilësimet. Përzgjidhni një llogari për të ndryshuar ► Të tjera ► Ndrysho llogarinë ► Cilësime të avanc. ► Postë Push dhe përzgjidhni një mundësi shtesë.

### ***Për ta fshirë një mesazh PE (POP3)***


- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Kutia në hyrje ► Të tjera.
- 2 ► Shenjo për fshirje ose ► Shenjo disa ► Shenjo ose Çshenjoje.



*Mesazhet e shenjuara do të fshihen kur të lidheni përsëri me serverin.*


### ***Për ta fshirë një mesazh PE (IMAP4)***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Mesazhimi ► PE ► Kutia në hyrje ► Të tjera.
- 2 ► Shenjo për fshirje ose ► Shenjo disa ► Shenjo ose Çshenjoje.
- 3 ► Të tjera ► Zbraz kutinë hyrje për t'i fshirë mesazhet.

 Të gjitha mesazhet e shenjuara për fshirje në telefon dhe në server do të fshihen.

## Shokët e mi

Lidhuni dhe hyni me login në serverin Shokët e mi për të komunikuar në linjë me shokët tuaj. Nëse pajtimtaria juaj e përballon mesazhimin e çastit dhe shërbimet e pranisë, mund të shkëmbeni mesazhe dhe të shihni gjendjen e kontaktit, kur jeni në linjë. Po të mos i keni cilësimet në telefon, duhet të futni cilësimet të serverit.

 Këshillohuni me ofruesin e shërbimit për të dhëna të mëtejshme.

### *Për t'i futur cilësimet e serverit*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Mesazhimi** ► **Shokët e mi** ► **Konfiguro**.
- 2 Shtoni emrin e përdoruesit, fjalëkalimin, të dhëna për serverin dhe përzgjidhni një profil Interneti për të përdorur. Këto të dhëna do t'ju japë ofruesi i shërbimit.

### *Për t'u futur me login në serverin Shokët e mi*

Telefoni juaj përballon shfletimin e sigurshëm. Disa shërbime në Internet, të tilla si shërbimet bankare, kërkojnë

të keni certifikata në telefon. Telefoni juaj mund t'i ketë pasur certifikatat që kur e bletë; por ju gjithashtu mund të shkarkoni certifikata të reja.

### ***Për të kontrolluar certifikatat që keni në telefon***

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**  
▶ Cilësimet ▶ kartela Të përgjithshme  
▶ Sigurshmëria ▶ Certifikata.

## **Lexuesi RSS**

Kur jeni duke shfletuar, mund të merrni materiale të përditësueshme, të tilla si tituj lajmesh, si burime nëpërmjet një faqeje në Web. Mund të shkoni te një faqe Interneti për të shtuar burime të reja, nëse këto ekzistojnë. Mundësitë shtesat të shërbimit RSS (Really Simple Syndication) cilësohen nëpërmjet lexuesit RSS dhe afishohen në shfletuesin e Internetit.

### ***Për t'i shtuar burime të reja një faqeje Interneti***

- Kur jeni duke shfletuar ▶ Të tjera  
▶ Burime RSS.

### ***Për të krijuar një burim të ri***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ Mesazhimi ▶ Lexuesi RSS ▶ Të tjera ▶ Burim i ri.
- 2 Futni adresën dhe përzgjidhni **Shko te**.

### ***Për të cilësuar dhe përdorur mundësitë shtesë të lexuesit RSS***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ Mesazhimi ▶ Lexuesi RSS ▶ Të tjera dhe përzgjidhni një mundësi shtesë.

## **Sinkronizimi**

Mund të sinkronizoni kontaktet në telefon, takimet, detyrat dhe shënimet me anë të radioteknologjisë Bluetooth™, shërbimeve në Internet ose kabllit USB që ju është dhënë së bashku me telefonin.

### **Sinkronizimi me një kompjuter**

Instaloni programe të sinkronizimit me kompjuterin të cilat gjenden në Sony Ericsson PC Suite në CD-në që ju ka ardhur me telefonin. Programet përmbajnë edhe të dhëna ndihmëse. Mund edhe të shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support) për të shkarkuar programet ose dokumentin *Synchronizing with a Computer* Getting started guide (Sinkronizimi me një kompjuter – Udhëzuesi hyrës).

### **Sinkronizimi në distancë, nëpërmjet Internetit**

Sinkronizohuni në linjë, nëpërmjet një shërbimi Interneti.

## Para se të filloni

- Po të mos i keni cilësimet në telefon  
➡ **70 Cilësimet.**
- Hapni një llogari sinkronizimi në linjë.
- Futni cilësimet për sinkronizimin në distancë.

## *Për të futur cilësimet të sinkronizimit në distancë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ **Organizuesi** ▶ **Sinkronizimi** ▶ **Po**  
për të krijuar një llogari të re për herë  
të parë ose **Llogari e re** ▶ **Shto** për  
të shtuar një llogari të re tjetër.
- 2 Futni një emër për llogarinë e re  
▶ **Vazhdo.**
- 3 Futni të dhënat e mëposhtme:
  - **Adresa e serverit** – URL-në e serverit.
  - **Emri përdoruesit** – emrin e përdoruesit për llogarinë.
  - **Fjalëkalimi** – fjalëkalimin për llogarinë.
  - **Lidhje** – përzgjidhni një profil Interneti.
  - **Aplikacione** – shenjoni aplikacionet për të sinkronizuar.
  - **Cilësimet e aplikac.** – përzgjidhni një aplikacion dhe futni emrin e një baze dhanore dhe, nëse ju kërkohet, emrin e përdoruesit dhe një fjalëkalim.

- **Interval sinkroniz.** – caktoni sa shpesh duhet bërë sinkronizimi.
  - **Nistim në distancë** – vendosni nëse gjithnjë do të pranoni, asnjëherë nuk do të pranoni, ose gjithnjë do të pyeteni para se të nisni sinkronizimin nga një shërbim.
  - **Sigurshmëri n'dist.** – futni një ID dhe një fjalëkalim të serverit.
- 4 ▶ **Ruaje** për ta ruajtur llogarinë e re.

## *Për ta filluar sinkronizimin në distancë*


- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ **Organizuesi** ▶ **Sinkronizimi** dhe  
përzgjidhni një llogari ▶ **Nise.**

## **Radioteknologjia Bluetooth™**

Funksioni Bluetooth™ mundëson radiolidhjen me pajisje të tjera Bluetooth. Ju mund:


- të lidheni me pajisje telefonimi pa duar.
- të lidheni me kufje stereo.
- të lidheni me disa pajisje njëkohësisht.
- të lidheni me kompjuterin dhe të futeni në Internet.
- të sinkronizoni të dhëna me kompjuterin.
- të përdorni aplikacione kompjuteri duke i telekomanduar.

- të përdorni pajisje shtesë për lexim mediash.
- të shkëmbeni objekte.

 *Për komunikimin Bluetooth, ne këshillojmë të ruani një distancë jo më të madhe se 10 metra (33 fut) midis pajisjeve, pa objekte solide ndërmjet.*

### **Para se të filloni**

- Ndizeni funksionin Bluetooth për të komunikuar me pajisje të tjera.
- Çiftoni pajisje Bluetooth me telefonin, për të komunikuar me to.

 *Kontrolloni nëse ligjet dhe rregulloret lokale e kufizojnë përdorimin e radioteknologjisë Bluetooth. Nëse radioteknologjia Bluetooth nuk lejohet të përdoret, sigurohuni që e keni fikur funksionin Bluetooth.*


### **Për ta aktivizuar funksionin Bluetooth**

- Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Bluetooth ► Aktivizoje.

### **Çiftimi i pajisjeve me telefonin**

Futni një kodkalim për të konfiguruar një lidhje të siguroshme midis telefonit tuaj dhe pajisjes. Futni të njëjtin kodkalim në pajisjen, kur t'ju kërkohet. Pajisjet pa ndërfaqe përdoruesi, si p.sh. pajisjet e telefonimit pa duar,

vijnë me kodkalim të paracaktuar. Të dhëna të mëtejshme do të gjeni në udhëzuesin e përdorimit të pajisjes.

 *Sigurohuni që pajisja që po gatiteni të shtoni e ka funksionin Bluetooth të aktivizuar dhe është e gjetshme.*

### **Për të shtuar pajisje në telefon**

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Bluetooth ► Pajisjet e mia ► Pajisje e re për të kërkuar për pajisje të përdorshme. Sigurohuni që pajisja tjetër është e gjetshme.
- 2 Përzgjidhni një pajisje nga lista.
- 3 Futni një kodkalim, nëse ju kërkohet.

### **Për të lejuar lidhjen ose për të ndryshuar listën e pajisjeve**

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Bluetooth ► Pajisjet e mia dhe përzgjidhni një pajisje nga lista.
- 2 ► Të tjera për të parë një listë mundësish shtesë.

### **Për të shtuar një kufje Bluetooth**

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Bluetooth ► Pa duar.

- 2 ► Po nëse po shtoni kufje Bluetooth për herë të parë ose ► Pajisjet pa duar ► Pajsje e re pa duar ► Shto nëse po shtoni një kufje të re Bluetooth. Sigurohuni që kufja është e përgatitur për lidhje. Të dhëna të mëtejshme do të gjeni në udhëzuesin e përdorimit të pajisjes.

### **Kursimi i baterisë**

Aktivizojeni këtë funksion për të ulur konsumin e baterisë duke e optimizuar telefonin tuaj për përdorim me një pajisje të vetme Bluetooth. Çaktivizojeni për t'u lidhur me disa pajisje Bluetooth njëkohësisht.

### ***Për të kursyer energji***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Bluetooth ► Kursim energjie ► Aktivizoje.

### **Emri i telefonit**

Vëri një emër telefonit, me të cilin do ta njohin pajisjet e tjera.

### ***Për t'i vënë emër telefonit***

- Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Bluetooth ► Emri i telefonit.

### **Gjetshmëria**

Vendosni nëse do ta keni telefonin të gjetshëm për pajisje të tjera Bluetooth apo jo. Po ta cilësoni telefonin si të fshehur, vetëm pajisje në Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Bluetooth ► Pajisjet e mia do të mund ta gjejnë nëpërmjet radioteknologjisë Bluetooth.

### ***Për ta treguar ose për ta fshehur telefonin***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Bluetooth ► Zbulueshmëria ► Bëje t'gjetshëm ose Fshihe telefonin.

### **Për të shkëmbyer objekte**

Dërgoni ose merrni objekte duke përdorur radioteknologjinë Bluetooth si mënyrë transferimi. Përzgjidhni një pajisje nga lista e pajisjeve të gjetura.

### ***Për të dërguar një objekt***

- 1 Përzgjidhni një objekt, për shembull, nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Kontaktet dhe përzgjidhni një kontakt.
- 2 ► Të tjera ► Dërgo kontaktin ► Me Bluetooth.
- 3 Përzgjidhni pajisjen ku do ta dërgoni objektin ► Përzgjidh.

### ***Për të marrë një objekt***

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja  
▶ Cilësimet ▶ kartela Lidhshmëria  
▶ Bluetooth ▶ Aktivizoje.
- 2 ▶ Zbulueshmëria ▶ Bëje t'gjetshëm.
- 3 Kur t'ju mbërrijë një objekt, ndiqni udhëzimet e afishuara.

### ***Për të transferuar zërin***

Kur po përdorni një pajisje pa duar Bluetooth, transferojeni zërin e telefonatës.

Mund gjithashtu të transferoni zërin e telefonatës duke përdorur tastierën ose butonin e pajisjes pa duar, si vijon.

- Shtypeni butonin e pajisjes pa duar për ta çuar zërin në atë pajisje.
- Shtypni një buton ose tast të telefonit (po të jetë cilësuar si **Në aparat**) për ta çuar zërin në telefon.
- Shtypni një buton çfarëdo (po të jetë cilësuar si **Te sist. pa-duar**) për ta çuar zërin në pajisjen pa duar.

### ***Për të transferuar zërin kur po përdorni një pajisje pa duar Bluetooth***

- Gjatë një telefonate, ▶ **Të tjera**  
▶ **Transfero zërin dhe përzgjidhni një pajisje.**

### ***Për të transferuar zërin kur po i përgjigjeni një telefonate nga sistemi pa duar***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja  
▶ Cilësimet ▶ kartela Lidhshmëria  
▶ Bluetooth ▶ Pa duar ▶ Telefonim në hyrje.
- 2 ▶ **Në aparat për ta adresuar në telefon ose ▶ Te sist. pa-duar për ta adresuar te pajisja pa duar.**

### ***Telekomandimi***

Përdoreni telefonin si pajisje telekomanduese për aplikacione kompjuterike të tilla si një lexues mediash ose paraqitje Microsoft® PowerPoint® ose pajisje që përballojnë profilin Bluetooth HID.

### ***Për të përzgjedhur telekomandimin***

- 1 ▶ **76 Për të shtuar pajisje në telefon, nëse kërkohet.**
- 2 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ▶ **Dëfrim ▶ Telekomandimi.**
- 3 Përzgjidhni një aplikacion për të përdorur dhe kompjuterin ose pajisjen për t'u lidhur.

## Transferimi i skedave

Në qoftë se kompjuteri juaj e përballon radioteknologjinë Bluetooth, mund të instaloni programin Sony Ericsson PC Suite për të sinkronizuar, transferuar skeda, përdorur telefonin si modem e më tej, nëpërmjet komunikimit Bluetooth. Instaloni Sony Ericsson PC Suite nga CD-ja që ju erdhi me telefonin ose shkarkojeni nga [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support). PC Suite ka edhe një seksion ndihme.

## Për të transferuar skeda me anë të kabllit USB


Lidhni telefonin me një kompjuter, nëpërmjet kabllit USB. Për të transferuar skeda, përdorni profilin **Transf skeda** ndërsa për sinkronizim të dhënash, përdorni profilin **Mod Telefon**.

## Transferimi i skedave

Transferoni skeda midis kartës suaj të kujtesës dhe kompjuterit, në një mjedis Microsoft Windows Explorer.


Përdorni programet Sony Disc2Phone (transferim muzike) ose Adobe™ Photoshop™ Album Starter Edition (transferim/arkivim fotosh). Këto aplikacione do t'i gjeni në CD-në që ju erdhi me telefonin ose në

[www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support), dhe mund të përdoren vetëm në profilin për transferim skedash.

 **Përdorni vetëm kabllin USB që ju është dhënë me telefonin dhe lidhni kabllin USB drejtpërdrejt me kompjuterin. Mos e hiqni kabllin USB nga telefoni ose kompjuteri gjatë transferimit të skedave meqë kjo mund ta dëmtojë kartën e kujtesës.**

## Për të përdorur profilin për transferim skedash

- 1 Lidhni kabllin USB me telefonin dhe kompjuterin.



- 2 **Telefon:** Përzgjidhni **Transf skeda** ose nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**
  - ▶ Cilësimet ▶ kartela Lidhshmëria
  - ▶ USB ▶ Lidhje USB ▶ Transf skeda.

3 Prisni derisa karta juaj e kujtesës të afishohet si disk i jashtëm në Windows Explorer. Mund të përdorni:

- Windows Explorer për të transferuar skeda midis kartës së kujtesës dhe kompjuterit.
- Sony Disc2Phone për të transferuar muzikë në kartën e kujtesës.
- Adobe™ Photoshop™ Album Starter Edition, për të transferuar dhe organizuar fotot tuaja në kompjuter.

### ***Për ta shkëputur kabllin USB në mënyrë korrekte***

- 1 Kur jeni në profilin për transferim skedash, djathtas-klikoni mbi ikonën e diskut portativ në Windows Explorer, dhe përzgjidhni *Eject*.
- 2 Hiqeni kabllin USB nga telefoni.

### **Profili telefon**

Sinkronizoni kontaktet dhe kalendarin, transferoni skeda, përdoreni telefonin si modem dhe për funksione të tjera në lidhje me kompjuterin. Profili telefon përbëhet këto aplikacione: Sinkronizimin, Skedarin dhe Udhëzimin e Rrjetëzimit Celular. Për aplikacione të tjera përdorni profilin e transferimit të skedave.

Duhet të instaloni dhe të përdorni programet Sony Ericsson PC Suite, të cilat gjenden në CD-në që ju erdhi me telefonin, ose në [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).



*Që të mund ta përdorë këtë funksion, kompjuteri juaj duhet të ketë Windows XP (Pro ose Home) me SP1/SP2. Pilotët USB do të instalohen automatikisht, kur të instalohen programet e PC Suite.*

### ***Për të përdorur profilin telefon***

- 1 **Në kompjuter:** Instaloni programin Sony Ericsson PC Suite nga CD-ja që ju erdhi me telefonin.
- 2 **Në kompjuter:** Niseni PC Suite nga *Start/Programs/Sony Ericsson/PC Suite*.
- 3 Lidhni kabllin USB me telefonin dhe kompjuterin.
- 4 **Telefon:** Përzgjidhni *Mod Telefon* ose nga gatishmëria përzgjidhni *Menuja ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► USB ► Lidhje USB ► Mod Telefon*.
- 5 **Në kompjuter:** Prisni derisa Windows të instalojë pilotët e nevojshëm.
- 6 **Në kompjuter:** Kur PC Suite ta ketë gjetur telefonin, do të njoftoheni. Në Sony Ericsson PC Suite do të gjeni të gjitha aplikacionet të cilat mund t'i përdorni me telefonin të lidhur.




## Shërbimi përditësues

Gjithnjë mbajeni telefonin të përditësuar me programet e fundit, që t'ju funksionojë sa më mirë. Kur e përditësoni telefonin nuk do të humbni të dhëna personale ose të telefonit, për shembull mesazhe ose cilësime.

Ka dy mënyra për ta përditësuar telefonin:

- Drejtpërdrejt nga telefoni.
- Duke e lidhur telefonin, nëpërmjet kabllit USB, me një kompjuter të lidhur në Internet.

 *Shërbimi përditësues kërkon lidhje dhanore (GPRS). Operatori juaj do t'ju japë një pajtimtari me lidhje dhanore si dhe të dhëna për tarifën.*

### Para se të filloni

Po të mos i keni cilësimet e nevojshme në telefon ➡ *70 Cilësimet*.

### *Për të përdorur shërbimin përditësues drejtpërdrejt*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**  
▶ **Cilësimet** ▶ **kartela Të përgjithshme**  
▶ **Shërbimi përditësues**.
- 2 ▶ **Kërko përditësim** për të kërkuar për versionet më të fundit të programeve.

- 3 Niseni procesin përditësues duke ndjekur udhëzimet e instalimit, ose  
▶ **Versioni progr.** për të parë se ç'programe keni tani në telefon, ose  
▶ **Përkujtesë** për të cilësuar se kur duhet të kërkonit për programe të reja.

### *Për të përdorur shërbimin përditësues nga kompjuteri*

- 1 Shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).
- 2 Përzgjidhni rajonin dhe shtetin.
- 3 Futni emrin e produktit.
- 4 Përzgjidhni Sony Ericsson Update Service dhe ndiqni udhëzimet.


## Tipare të tjera

*Ora me zile, kalendari, detyrat, profilet, ora dhe data, kyçi i kartës SIM etj.*

### Alarmet

Programoni një alarm që të bjerë në një orë të caktuar, ose në ditë të caktuara.

#### *Për të përdorur alarmet*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**  
▶ **Organizuesi** ▶ **Alarmet** dhe përzgjidhni një alarm për të cilësuar  
▶ **Ndrysho**.
- 2 **Ora:** ▶ **Ndrysho** dhe cilësoni orën  
▶ **OK**. Përzgjidhni mundësi të tjera shtesë, po t'ju kërkohet:
  - **Periodik:** ▶ **Ndrysho** dhe cilësoni ditën ose ditët ▶ **Shenjo** ▶ **Mbarova**.
  - **Sinjali i alarmit:** ▶ **Ndrysho** dhe përzgjidhni një sinjal akustik.
  - **Shtypni**  për të ndryshuar tekstin, fotot dhe profilin e heshtur për alarmet.
- 3 ▶ **Ruaje**.

*Për ta fikur sinjalin e alarmit kur është duke rënë*

- Shtypni një tast çfarëdo. Nëse nuk doni që alarmi të përsëritet ▶ **Fike**.

### *Për ta anuluar një alarm*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ **Organizuesi** ▶ **Alarmet** dhe përzgjidhni një alarm, ▶ **Fike**.

### Kalendari

Kalendarin mund ta përdorni për të mbajtur mend takime të rëndësishme. Kalendari mund të sinkronizohet me një kalendar në kompjuter ose një kalendar në Internet ➡ **74 Sinkronizimi**.

#### Takimet

Shtoni takime të reja, ose përdorni takimet ekzistuese si modele.

#### *Për të shtuar një takim të ri*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ **Organizuesi** ▶ **Kalendari** dhe përzgjidhni një datë ▶ **Përzgjidh**  
▶ **Takim i ri** ▶ **Shto**.
- 2 Përzgjidhni nga mundësitë shtesë të mëposhtme dhe konfirmojeni çdo futje, po t'ju kërkohet:
  - **Kartela Të përgjithshme** – lënda, ora e nisjes, kohëzgjatja, përkujtesa, data e nisjes.
  - **Kartela Hollësi** – vendi, përshkrimi, gjithë ditën, periudhshmëria.
- 3 ▶ **Ruaje**.

## ***Për parë një takim***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Organizuesi ► Kalendari dhe përzgjidhni një ditë (ditët e takimeve shenjohe me shkronja të theksuara).
- 2 Përzgjidhni një takim ► Shih.





## ***Për të parë një javë kalendari***








- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Organizuesi ► Kalendari ► Të tjera ► Shih javën.

## ***Për të cilësuar kur do të lajmërohen përkujtesat***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Organizuesi ► Kalendari ► Të tjera ► Të avancuara ► Përkujtesat.
- 2 ▶ Gjithnjë që të përkujtoheni edhe me telefon të fikur ose të heshtuar. Kur të afishohet përkujtesa ► Po për ta lexuar takimin ose ► Jo për ta fikur përkujtesën. Po të ndryshoni një cilësim përkujtese në kalendar, kjo do të prekë edhe një cilësim përkujtese në detyrat.

## ***Për të lundruar në kalendar***

Shtypni , ,  dhe  për t'u zhvendosur midis ditëve ose javëve. Në pamjet mujore dhe javore, mund të përdorni edhe tastierën si vijon.

- 
- |  |  |
|--|--|
|  1 Një javë prapa  |  Data e sotme         |
|  4 Një muaj prapa |  3 Java e ardhshme   |
|  7 Një vit prapa  |  6 Muaji i ardhshëm |
|  |  9 Viti i ardhshëm  |
- 

## ***Cilësimet e kalendarit***

Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Organizuesi ► Kalendari ► Të tjera për të përzgjedhur një mundësi shtesë:

- Shih javën – shihni takimet asaj jave.
- Takim i ri – shtoni një takim të ri.
- Ndërro datën – shkoni te një datë tjetër në kalendar.
- Të avancuara – gjeni një takim, cilësoni përkujtesa ose përzgjidhni një ditë fillimi për javën.
- Fshije – fshini takime të vjetra ose të gjitha takimet.
- Ndihmë – për të dhëna të mëtejshme.

## ***Për të shkëmbyer takime***

Takimet mund t'i shkëmbeni duke përdorur një metodë transferimi. Gjithashtu mund t'i sinkronizoni takimet me një kompjuter

► 74 Sinkronizimi.

### ***Për të dërguar një takim***

- Përzgjidhni një takim nga lista për një ditë të caktuar ► Të tjera ► Dërgoje dhe përzgjidhni një mënyrë transferimi.

## **Detyrat**

Shtoni detyra të reja, ose përdorni detyrat ekzistuese si modele. Mund edhe të cilësoni përkujtesa për detyrat.



*Numri maksimal i detyrave varet nga kujtesa e përdorshme, sipas cilësimit përkatës.*

### ***Për të shtuar një detyrë të re***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Organizuesi ► Detyrat ► Detyrë e re ► Shto.
- 2 ► Detyrë ose Telefonatë.
- 3 Futni hollësitë dhe konfirmoni çdo futje.

### ***Për të parë një detyrë***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Organizuesi ► Detyrat dhe përzgjidhni një detyrë ► Shih.

### ***Për të cilësuar kur do të lajmërohen përkujtesat***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Organizuesi ► Detyrat dhe përzgjidhni një detyrë ► Të tjera ► Përkujtesat.

- 2 ► Gjithnjë që një përkujtesë të dëgjohet edhe me telefon të fikur ose të heshtuar. Kur të dëgjohet përkujtesa ► Po për ta lexuar detyrën, ose për t'i telefonuar numrit në një detyrë telefonimi. ► Jo për ta fikur përkujtesën. Po të ndryshoni një cilësim përkujtesë në detyrat, kjo do të prekë edhe një cilësim përkujtesë në kalendar.

### ***Për të shkëmbyer detyra***

Detyrat mund t'i shkëmbeni duke përdorur një metodë transferimi. Gjithashtu mund t'i sinkronizoni detyrat me një kompjuter ► 74 Sinkronizimi.

### ***Për të dërguar një detyrë***

- Përzgjidhni një detyrë nga lista e detyrave për një ditë të caktuar ► Të tjera ► Dërgoje dhe përzgjidhni një mënyrë transferimi.

## **Shënimet**

Mbani shënime dhe ruajini në një listë. Mund edhe të vendosni të afishoni një shënim në gatishmëri.



*Numri maksimal i shënimeve varet nga kujtesa e përdorshme, sipas cilësimit përkatës.*

### *Për të shtuar një shënim*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - ▶ **Organizuesi** ▶ **Shënime** ▶ **Shënim i ri** ▶ **Shto dhe futeni shënimin** ▶ **Ruaje**.

### *Për të ndryshuar shënimet*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - ▶ **Organizuesi** ▶ **Shënime** dhe do të afishohet një listë.
- 2 Përzgjidhni një shënim ▶ **Të tjera** dhe përzgjidhni një mundësi shtesë.

### *Për të shkëmbyer shënime*

Shkëmbeni shënime duke përdorur një nga mënyrat e transferimit që ju ofrohen. Gjithashtu mund t'i sinkronizoni shënimet me një kompjuter ➤ [74 Sinkronizimi](#).

### *Për të dërguar një shënim*

- Përzgjidhni një shënim ▶ **Të tjera**
  - ▶ **Dërgoje** dhe përzgjidhni një mënyrë transferimi.

## **Kohëmatësi**

Telefoni ju vjen me një kohëmatës. Kur të dëgjohet sinjali, shtypni një tast çfarëdo për ta fikur ose përzgjidhni **Rinis**.

### *Për ta cilësuar kohëmatësin*

- **Organizuesi** ▶ **Kohëmatësi** dhe cilësoni orët, minutat dhe sekondat për numërimin së prapthi.

## **Kronometri**

Telefoni përmban një kronometër, që mund të ruajë disa xhiro. Kronometri vazhdon të punojë kur i përgjigjeni një telefonate në hyrje.





### *Për të përdorur kronometrin*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - ▶ **Organizuesi** ▶ **Kronometri** ▶ **Nise**.
- 2 ▶ **Stop** ose ▶ **Xhiro** e re për t'ia matur kohën xhiros tjetër.
- 3 Për ta ricilësuar kronometrin ▶ **Stop**
  - ▶ **Ricilësoje**.

## **Llogaritësja**

Llogaritësja mund të kryejë veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit.

### *Për të përdorur llogaritësen*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**
  - ▶ **Organizuesi** ▶ **Llogaritësja**.
  - ▶ Shtypni  ose  për të përzgjedhur  $\div$   $\times$   $-$   $+$   $.$   $\%$   $=$ .
  - ▶ Shtypni  për ta fshirë shifrën.
  - ▶ Shtypni  për të futur një pikë dhjetore.

## Kujtesa e kodeve

Në kujtesën e kodeve mund të ruani kodet e sigurshmërisë, si ato të kartave të kreditit. Cilësoni një fjalëkalim për ta hapur kujtesën e kodeve.

### Fjalëkontrolli dhe sigurshmëria

Për të konfirmuar që keni futur kodkalimin e duhur, duhet të futni një fjalëkontroll.

Kur futni kodkalimin për të hapur kujtesën e kodeve, fjalëkontrolli do të afishohet për pak sekonda. Po të keni futur kodkalimin e duhur, do t'ju tregohen kodet e sakta. Po të keni futur kodkalim të gabuar, fjalëkontrolli dhe kodet e afishuara do të jenë gjithashtu të gabuara.

### *Për ta hapur kujtesën e kodeve për herë të parë*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Organizuesi** ► **Kujtesa kodeve**. Do të afishohet një mesazh me udhëzime ► **Vazhdo**.
- 2 Futni një kodkalim katërshifror ► **Vazhdo**.
- 3 Rishkruajeni kodkalimin e ri për ta konfirmuar.
- 4 Futni një fjalëkontroll (jo më të gjatë se 15 shenja) ► **Mbarova**. Fjalëkontrolli mund të përmbajë edhe shkronja edhe numra.

### *Për të shtuar një kod të ri*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Organizuesi** ► **Kujtesa kodeve dhe futeni kodkalimin** ► **Kod i ri** ► **Shto**.
- 2 Futni një emër të bashkëlidhur me kodin ► **Vazhdo**.
- 3 Futni kodin ► **Mbarova**.

### *Për ta ndryshuar kodkalimin*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Organizuesi** ► **Kujtesa kodeve dhe futeni kodkalimin** ► **Të tjera** ► **Ndrro kodkalimin**.
- 2 Futni kodkalimin e ri ► **Vazhdo**.
- 3 Futni edhe një herë kodkalimin e ri ► **Vazhdo**.
- 4 Futni një fjalëkontroll ► **Mbarova**.

### **E harruat fjalëkontrollin?**

Në qoftë se e harroni fjalëkontrollin, duhet ta ricilësoni kujtesën e kodeve.

### *Për ta ricilësuar kujtesën e kodeve*

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja** ► **Organizuesi** ► **Kujtesa kodeve dhe futni një kodkalim çfarëdo për të hyrë në kujtesën e kodeve**. Fjalëkontrolli dhe kodet që do të afishohen janë të gabuara.
  - 2 ► **Të tjera** ► **Ricilësoji**.

### 3 Ta ricolësoj kujtesën e kodeve?

afishohet ► Po. Kujtesa e kodeve do të ricolësohet dhe të gjitha kodet atje do të fshihen. Kur të hyni në kujtesën e kodeve herën e ardhshme, duhet të nisni nga ► 86 *Për ta hapur kujtesën e kodeve për herë të parë.*

## Profilet

Telefoni ju vjen me profile të paracilësuar. Disa prej tyre, për shembull volumi i ziles dhe mundësi të tjera shtesë mund të përshtaten automatikisht sipas mjedisit ku ndodhni ose pajisjes shtesë që përdorni. Cilësimet e profileve mund t'i riktheni të gjitha ashtu siç ishin kur e bletë telefonin.

### *Për të përzgjedhur një profil*

- Shtypni ① dhe përzgjidhni një profil, ose nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartelën Të përgjithshme ► Profilet dhe përzgjidhni një profil.

### *Për të parë dhe ndryshuar një profil*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Profilet ► Të tjera ► Shih dhe ndrysho.



*Profilin Normal nuk mund ta riemërtoni.*

### *Për t'i ricolësuar profilet*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Profilet ► Të tjera ► Ricolësoji profilet.

## Ora dhe data

Ora gjithnjë do të afishohet në gatishmëri.

### *Për të cilësuar orën dhe formatin e orës*

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Ora dhe data ► Ora.
- 2 Futni orën.
- 3 ► Formatin dhe përzgjidhni një mundësi shtesë.
- 4 ► Ruaje.

### *Për të cilësuar datën dhe formatin e datës*

- Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Ora dhe data ► Data.

## Kyçi i kartës SIM

Kyçi i kartës SIM jua mbron pajtimtarinë, por jo telefonin vetë, ndaj përdorimit të paautorizuar. Në rast se ndërroni kartat SIM, telefoni juaj gjithnjë do të punojë me kartën e re.

Pjesa më e madhe e kartave SIM janë të kyçura kur i bleni. Në rast se kyçi i kartës SIM është aktiv, do t'ju duhet të futni një PIN (Numër të Identitetit Personal, ose «Personal Identity Number» në anglishte) sa herë që e ndizni telefonin.

Në qoftë se e futni gabim kodin PIN tri herë radhazi, karta SIM do të bllokohet. Kjo do t'ju njoftohet nga kumti PIN i bllokuar. Për ta zhblokuar, duhet të futni kodin PUK (Numrin Personal të Zhblokimit ose «Personal Unblocking Key» në anglishte). Kodet PIN dhe PUK do t'ju jepen nga operatori i rjetit. Mund ta ndryshoni kodin PIN dhe të krijoni një kod të ri katër- deri në tetëshifror.



*Po të afishohet kumti Kodet nuk përputhen kur jeni duke ndryshuar kodin PIN, e keni futur gabim kodin e ri PIN. Në rast se afishohet kumti PIN i gabuar, i pasuar nga PIN i vjetër, e keni futur gabim kodin e vjetër PIN.*

### ***Për ta zhblokuar kartën SIM***

- 1 Kur të afishohet kumti PIN i bllokuar, futni kodin PUK ► OK.
- 2 Futni një PIN të ri katër- deri në tetëshifror ► OK.
- 3 Rishkruejeni PIN-in e ri për ta konfirmuar ► OK.

### ***Për ta ndërruar kodin PIN***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Sigurshmëria ► Kyçet ► Mbrojtja e SIM ► Ndërro PIN.
- 2 Futni kodin PIN ► OK.
- 3 Futni një PIN të ri katër- deri në tetëshifror ► OK.
- 4 Rishkruejeni PIN-in e ri për ta konfirmuar ► OK.

### ***Për ta aktivizuar ose çaktivizuar kyçin e kartës SIM***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja ► Cilësimet ► kartela Të përgjithshme ► Sigurshmëria ► Kyçet ► Mbrojtja e SIM ► Mbrojtja dhe përzgjidhni Aktiv ose Joaktiv.
- 2 Futni kodin PIN ► OK.


### ***Kyçi i telefonit***

Mbrojeni telefonin kundër përdorimit të paautorizuar, në rast se jua vjedhin dhe kartën SIM e ndërrojnë. Kodin (0000) e kyçjes së telefonit mund ta ndërroni me një tjetër kod personal katër deri në tetëshifror.



## Kyçja automatike e telefonit

Në rast se kyçi i telefonit është programuar si automatik, nuk keni nevojë ta futni kodin përveçse kur të instalohet një tjetër kartë SIM në telefon.

 *Ka rëndësi që ta mbani mend kodin e ri. Po ta harroni, duhet ta çoni telefonin tek tregtorja Sony Ericsson në zonën tuaj.*

### ***Për ta cilësuar kyçin bllokues të telefonit***

- 1 Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja  
▶ Cilësimet ▶ kartela Të përgjithshme  
▶ Sigurshmëria ▶ Kyçet ▶ Mbrojtja telefonit ▶ Mbrojtja dhe përzgjidhni një mundësi shtesë.
- 2 Futni kodin e kyçjes së telefonit ▶ OK.

### ***Për ta shkyçur telefonin***


- Në rast se funksioni i kyçjes është aktiv, futni kodin ▶ OK.

### ***Për ta ndërruar kodin e kyçit të telefonit***

- Nga gatishmëria, përzgjidhni Menuja  
▶ Cilësimet ▶ kartela Të përgjithshme  
▶ Sigurshmëria ▶ Kyçet ▶ Mbrojtja telefonit ▶ Ndërro kodin.

## Kyçi i tastierës

Tastierën mund ta kyçni, për të mos i rënë ndonjë numri pa dashur.

 *Edhe kur tastiera është e kyçur, gjithnjë mund t'i telefononi numrit ndërkombëtar të urgjencës 112.*


### **Tastkyçja automatike**

Përdoreni funksionin e tastkyçjes automatike në gatishmëri për ta kyçur tastierën pak kohë pasi të keni shtypur një tast për herë të fundit.


### ***Për ta cilësuar tastkyçjen automatike***

- Nga gatishmëria përzgjidhni Menuja  
▶ Cilësimet ▶ kartela Të përgjithshme  
▶ Sigurshmëria ▶ Tastkyçje autom.

### ***Për të kyçur tastierën ju vetë***

- Nga gatishmëria, shtypni  **Kyç.tastet**. Gjithnjë mund t'i përgjigjeni një telefonate në hyrje, pastaj tastiera do të kyçet prapë pas telefonatës. Tastiera do të mbetet e kyçur derisa ta shkyçni ju vetë.

### ***Për ta shkyçur tastierën ju vetë***

- Nga gatishmëria, shtypni  **Shkyçe**.



## Ekрани përshëndetës

Përzgjidhni një ekran përshëndetës që të afishohet kur ta ndizni telefonin  
➤ 56 Ç'mund të bëni me fotot.

### *Për përzgjedhur një ekran përshëndetës*

- Nga gatishmëria, përzgjidhni **Menuja**  
▶ Cilësimet ▶ kartela Ekрани ▶ Ekрани në hapje dhe përzgjidhni një mundësi shtesë.

## Shkëlqimi

Ekranit mund t'ia ndryshoni shkëlqimin.

### *Për të cilësuar shkëlqimin*

- Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja**  
▶ Cilësimet ▶ kartela Ekрани  
▶ Ndriçimi.

## Mënjanimi i problemeve

*Pse nuk punon telefoni ashtu siç e dua unë të punojë?*

Ky kapitull trajton disa probleme që mund të ndeshni kur përdorni telefonin. Për disa probleme i duhet telefonuar operatorit të rrjetit, por të shumtën e problemeve të tjera mund t'i zgjidhni me lehtësi ju vetë.

Gjithsesi, nëse duhet ta çoni telefonin për riparime, kini parasysh se mund të humbni të dhëna dhe materiale që kishit ruajtur në telefon. Është mirë t'i kopjoni diku tjetër këto të dhëna, para se ta çoni telefonin për ta riparuar.

Për ndihmë të mëtejshme, shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support).

### *Më dalin probleme me kapacitetin dhe shpejtësinë e kujtesës, ose telefoni punon ngadalë*

*Shkak i mundshëm:* Kujtesa e telefonit është plot, ose materialet në kujtesë nuk janë të organizuara mirë.

*Zgjidhja:* Riniseni telefonin çdo ditë për të liruar vend në kujtesë dhe për t'ia shtuar kapacitetin telefonit.

Mund edhe të bëni një Ricilëso të gjitha. Nëse veproni kështu, do të humbni disa të dhëna personale dhe cilësime që keni futur ju vetë  
➡ 93 Ricilësimi bazë.

### **Kur nis ta ngarkoj telefonin, nuk afishohet ndonjë ikonë baterie**

**Shkak i mundshëm:** Bateria është krejt e shkarkuar ose nuk është përdorur për shumë kohë.

**Zgjidhja:** Mund të kalojnë deri në 30 minuta para se ikona e baterisë të afishohet në ekran.

### **Disa menu më dalin ngjyrë hiri**

**Shkak i mundshëm:** Shërbimi nuk është aktivizuar ose pajtimtaria juaj nuk e përballon funksionin.

**Zgjidhja:** Lidhuni me operatorin e rrjetit.

**Shkak i mundshëm:** Meqë nuk mund të dërgoni figura dhe tinguj të mbrojtur me të drejta të autorit, menuja Dërgoje ndonjëherë s'mund të përdoret.

### **Nuk e kuptoj gjuhën në menutë**

**Shkak i mundshëm:** Gjuha në telefon është cilësuar gabim.

**Zgjidhja:** Ndërrojeni gjuhën  
➡ 17 Gjuha në telefon.

### **Nuk e ndez dot telefonin**

**Shkak i mundshëm:** Bateria është shkarkuar.

**Zgjidhja:** Ringarkojeni baterinë  
➡ 6 Për të ngarkuar baterinë.

**Zgjidhja:** Ndizeni telefonin me bateringarkuesin të lidhur. Po të ndizet telefoni, riniseni tashmë pa bateringarkues të lidhur.

### **Nuk e ngarkoj dot telefonin ose kapaciteti i baterisë është i ulët**

**Shkak i mundshëm:** Bateringarkuesi nuk është lidhur mirë me telefonin.

**Zgjidhja:** Sigurohuni që konektori i bateringarkuesit futet mirë në fole gjatë lidhjes  
➡ 6 Për të ngarkuar baterinë.

**Shkak i mundshëm:** Ka probleme me kontaktet e baterisë.

**Zgjidhja:** Hiqeni baterinë dhe pastrojini kontaktet. Mund të përdorni një furçë të butë, një leckë ose një toptoh pambuku të njomur me alkool. Sigurohuni që bateria është tharë krejt para se ta futni prapë në vend. Sigurohuni që konektorët e baterisë në telefon nuk janë dëmtuar.

**Shkak i mundshëm:** Bateria është konsumuar dhe duhet zëvendësuar.

*Zgjidhja:* Provoni një bateri dhe batingarkues tjetër për të njëjtin model telefoni, ose shkoni në tregtare dhe kërkoni që t'ju verifikojnë nëse bateria dhe batingarkuesi po punojnë si duhet.

### **Telefoni më fiket vetvetiu**

*Shkak i mundshëm:* Keni shtypur pa dashur butonin ①.

*Zgjidhja:* Aktivizoni tastkyçjen automatike, ose kyçeni tastierën ju vetë ➤ *89 Kyçi i tastierës.*

*Shkak i mundshëm:* Ka probleme me kontaktet e baterisë.

*Zgjidhja:* Sigurohuni që bateria është e futur mirë ➤ *6 Për të futur baterinë.*

### **Nuk po i përdor dot mesazhet shkrimore/SMS në telefon.**

*Shkak i mundshëm:* Cilësimet mungojnë ose nuk janë korrekte.

*Zgjidhja:* Lidhuni me operatorin e rrjetit për të marrë cilësimet e duhura për qendrën e shërbimit SMS ➤ *39 Mesazhimi shkrimor (SMS).*

### **Nuk po i përdor dot mesazhet-figurë/ MMS në telefon**

*Shkak i mundshëm:* Pajtimtaria juaj nuk e parashikon transmetimin e të dhënave.

*Zgjidhja:* Lidhuni me operatorin e rrjetit.

*Shkak i mundshëm:* Cilësimet mungojnë ose nuk janë korrekte.

*Zgjidhja:* ➤ *7 Ndihma në telefon* ose shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support), përzgjidhni rajonin ose shtetin tuaj, dhe zgjidhni Phone setup (konfigurimi i telefonit). Pastaj zgjidhni modelin e telefonit, klikoni mbi Read more (Lexoni më tej) në menunë e Picture messaging (Mesazhimit-figurë ose MMS) dhe ndiqni udhëzimet ➤ *70 Cilësimet.*

### **Nuk po e përdor dot Internetin**

*Shkak i mundshëm:* Pajtimtaria juaj nuk e parashikon transmetimin e të dhënave.

*Zgjidhja:* Lidhuni me operatorin e rrjetit.

*Shkak i mundshëm:* Cilësimet e Internetit mungojnë ose nuk janë korrekte.

*Zgjidhja:* ➤ *7 Ndihma në telefon* ose shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support), përzgjidhni rajon ose shtetin tuaj, dhe zgjidhni Phone setup (konfigurimi i telefonit). Pastaj zgjidhni modelin

e telefonit, klikoni mbi Read more (Lexoni më tej) në menunë e Internetit celular (Mobile Internet ose WAP) dhe ndiqni udhëzimet ➡ 70 Cilësimet.

### **Telefoni është i pagjetshëm prej përdoruesve të tjerë që përdorin radioteknologjinë Bluetooth™**

*Shkak i mundshëm:* Nuk e keni aktivizuar funksionin Bluetooth.

*Zgjidhja:* Sigurohuni që funksioni Bluetooth është aktiv dhe telefoni është cilësuar si i gjatshëm ➡ 78 Për të marrë një objekt.

### **Nuk e sinkronizoj dot telefonin me kompjuterin, as transferoj dot të dhëna, kur përdor kabllin USB që më është dorëzuar me telefonin.**

*Shkak i mundshëm:* Kablli nuk është instaluar si duhet dhe nuk është njohur nga kompjuteri, ose programet që ju erdhën me telefonin nuk janë instaluar si duhet në kompjuter.

*Zgjidhja:* Shkoni te [www.sonyericsson.com/support](http://www.sonyericsson.com/support), përzgjidhni rajonin dhe shtetin tuaj, dhe zgjidhni modelin e telefonit. Pastaj zgjidhni Learn more - Getting started (Mësoni më shumë - Për të filluar). Udhëzuesi *Synchronizing with a computer* (Sinkronizimi me një kompjuter) përmban udhëzime

për instalimin dhe një udhëzues për mënjanimin e problemeve, që mund t'ju ndihmojë t'i gjeni zgjidhje problemit.

### **Ricilësimi bazë**

Ndryshimet që u keni bërë cilësimeve dhe materialet që keni shtuar ose ndryshuar, do të fshihen.

Po të përzgjidhni **Ricilëso cilësimet**, ndryshimet që u keni bërë cilësimeve do të fshihen.

Po të përzgjidhni **Ricilësoji të gjitha**, përveç ndryshimeve që keni bërë në cilësimet, edhe kontaktet, mesazhet, të dhënat personale dhe materialet që keni shkarkuar, marrë ose përpunuar do të fshihen.

### **Për ta ricilësuar telefonin**

- 1 Nga gatishmëria përzgjidhni **Menuja** ► **Cilësimet** ► **kartela Të përgjithshme** ► **Ricilëso të gjitha**.
- 2 ► **Ricilëso cilësimet ose** ► **Ricilësoji të gjitha**.
- 3 Kur të afishohen udhëzime ► **Vazhdo**.



*Në rast se përzgjidhni **Ricilësoji të gjitha**, do të fshihen edhe materialet të tilla si meloditë dhe figurat që keni shkarkuar, marrë me mesazhe ose ndryshuar ju vetë.*

## Mesazhet e gabimit

### Fut një kartë SIM

*Shkak i mundshëm:* Nuk keni kartë SIM në telefon, ose e keni instaluar gabim.

*Zgjidhja:* Futni një kartë SIM ➤ 6 Për të futur kartën SIM.

*Shkak i mundshëm:* Kontaktet e kartës SIM duhen pastruar.

*Zgjidhja:* Hiqeni kartën SIM dhe pastrojeni. Gjithashtu sigurohuni që karta nuk është dëmtuar në mënyrë të tillë që të mos lidhet dot me kontaktet në trup të telefonit. Nëse është ashtu, lidhuni me operatorin e rrjetit për t'i kërkuar një kartë të re SIM.

### Fut një kartë SIM korrekte

*Shkak i mundshëm:* Telefoni është programuar të punojë vetëm me disa karta SIM të caktuara.

*Zgjidhja:* Sigurohuni që po përdorni kartën e duhur SIM në telefon.

### PIN i gabuar/PIN2 i gabuar

*Shkak i mundshëm:* E keni futur gabim kodin PIN ose PIN2.

*Zgjidhja:* Futni PIN ose PIN2 korrekt ➤ Po ➤ 87 Kyçi i kartës SIM.

### PIN i bllokuar/PIN2 i bllokuar

*Shkak i mundshëm:* E keni futur kodin PIN ose PIN2 gabim tri herë radhazi.

*Zgjidhja:* Për ta zhblokuar ➤ 87 Kyçi i kartës SIM.

### Kodet nuk përputhen

*Shkak i mundshëm:* Dy kodet që keni futur nuk përputhen.

*Zgjidhja:* Kur jeni duke ndërruar një kod të sigurshmërisë (për shembull, PIN) duhet ta konfirmoni kodin e ri duke e rifitur saktësisht. ➤ 87 Kyçi i kartës SIM.

### Nuk ka rrjet

*Shkak i mundshëm:* Telefoni është profiluar për avion.

*Zgjidhja:* Riniseni telefonin në profilin normal ➤ 8 Menuja e profilit Avion.

*Shkak i mundshëm:* Telefonit nuk po i vjen ndonjë sinjal radio, ose sinjali është tepër i dobët.

*Zgjidhja:* Lidhuni me operatorin e rrjetit dhe sigurohuni nëse ka mbulim rrjeti aty ku gjendeni. Për të kërkuar një rrjet, ► Cilësimet ► kartela Lidhshmëria ► Rrjetet celulare ► Kërkim i ri.

*Shkak i mundshëm:* Karta SIM nuk po punon mirë.

*Zgjidhja:* Futeni kartën SIM në një telefon tjetër. Nëse merrni të njëjtin mesazh ose një mesazh të ngjashëm, lidhuni me operatorin e rrjetit.

*Shkak i mundshëm:* Telefoni nuk po punon mirë.

*Zgjidhja:* Futeni kartën SIM në një telefon tjetër. Nëse punon, atëherë problemi pas gjase ka të bëjë me telefonin. Lidhuni me qendrën më të afërt të shërbimit Sony Ericsson.

#### **Vetm tlf. urgjence**

*Shkak i mundshëm:* Jeni vërtet brenda rrezes së një rrjeti, por nuk ju lejohet ta përdorni. Megjithatë, në rast të një urgjence, disa operatorë rrjeti ju lejojnë t'i telefononi numrit ndërkombëtar të urgjencës 112.

*Zgjidhja:* Mund t'ju duhet të ndërroni vend, derisa sinjali në hyrje të forcohet. Lidhuni me operatorin e rrjetit dhe sigurohuni se keni pajtimtarinë e duhur ➤ *23 Telefonata të urgjencës.*

#### **Kyçet e tlfonit**

*Shkak i mundshëm:* Telefoni është kyçur.

*Zgjidhja:* Për ta shkyçur telefonin ➤ *88 Kyçi i telefonit.*

#### **Kodi kyçës i tel.:**

*Shkak i mundshëm:* Ju kërkohet kodi kyçës i telefonit.

*Zgjidhja:* Futni kodin e kyçjes së telefonit. Kodi kyçës default është 0000 ➤ *88 Kyçi i telefonit.*

#### **PUK i bllokuar. Lidhu me operatorin.**

*Shkak i mundshëm:* E keni shkruar kodin PUK gabim 10 herë radhazi.

*Zgjidhja:* Lidhuni me operatorin e rrjetit.

#### **Po ngarkoj, bateri e huaj**

*Shkak i mundshëm:* Po përdorni një bateri të pamiratuuar nga Sony Ericsson.

*Zgjidhja:* ➤ *99 Bateria.*

# Të dhëna të rëndësishme

*Selia në Web e Sony Ericsson për konsumatorin, shërbim dhe asistencë teknike, përdorim i sigurt dhe i frytshëm, marrëveshja e licensës së përdoruesit, garancia, declaration of conformity.*

## Selia në Internet e Sony Ericsson për Konsumatorin

